BANKA E SHQIPËRISË

BULETINI EKONOMIK

Botim tremujor

Shtator 2003

Artikujt e paraqitur në këtë botim, nuk shprehin gjithmonë opinionin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Këtyre artikujve lutemi t'u referoheni si mendime personale të autorëve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel : 355-4-222230; 235568; 235569;
Faks : 355-4-223558

Për komentet dhe sugjerimet tuaja na shkruani në:
Sektori i Publikimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun.
public@bankofalbania.org
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 1200 kopje

BULETINI EKONOMIK TREMUJOR

SHTATOR 2003

PËRMBAJTJA

ROLI I STATISTIKAVE NË FUNKSION TË POLITIKËS MONETARE
PROF. SHKËLQIM CANI, GRAMOZ KOLASI, REFERATI I PARAQITUR NË SESIONIN E 54-T TË ISI, "ROLI I STATISTIKAVE NË FUNKSION TË POLITIKËS MONETARE TË BANKËS SË SHQIPËRISË" 19 GUSHT 2003, BERLIN 5

1. Hyrje 5

2. Statistikat makroekonomike në Shqipëri 6

3. Politika monetare në Shqipëri. 8

4. Statistikat dhe procesi i vendimmarrjes 11

5. E ardhmja: regjim inflacioni (Inflation Targeting) apo... ? 15

6. Përfundime 18

FJALË PËRSHËNDETËSE NË KONFERENCËN E KATËRT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NGA Z. SHKËLQIM CANI, GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË. SARANDË, 11 SHTATOR 2003 21

FJALA E GUVERNATORIT NË DREKËN E PËRSHËNDETUR NGA Z. KEMAL DERVIS SARANDË, 11 SHTATOR 2003 23

REFERATI "LIBERALIZIMI I LLOGARISË KAPITALE: PSE, KUR DHE SI?" MBAJTUR NGA Z.SHKËLQIM CANI, GUVERNATOR DHE ZNJ.DIANA SHTYLLA, SPECIALSTE NË KONFERENCËN IV TE BANKES SE SHQIPERISE. SARANDË,11 SHTATOR 2003 24

1. Ç'është liberalizimi i llogarisë kapitale: argumente pro dhe kundër dhe një historik i shkurtër. 24

2. Shkalla e liberalizimit të llogarisë kapitale në Shqipëri dhe arsyet pas flukseve hyrëse modeste. 27

3. Pse jemi për liberalizimin e llogarisë kapitale? 30

4. Kushtet për liberalizimin e llogarisë kapitale dhe situata në Shqipëri. 32

5. Hapat e sugjeruar për liberalizimin e llogarisë kapitale në Shqipëri 35

FJALA E GUVERNATORIT Z.SHKËLQIM CANI NË VLERËSIMIN E EKONOMISË PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2003 39

BULETINI I LAJMEVE, KORRIK-GUSHT-SHTATOR 2003 42

NGJARJET JURIDIKE 49

LISTA E DREJTUESVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, SHTATOR 2003 53

LICENCË NR. 01, DATË 02 . 07. 2003 PËR HAPJEN E ZYRËS SË PËRFAQËSIMIT TË BANKËS POPULLORE PULIEZE NË SHQIPËRI 55

LISTA E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË 57

Banka dhe degë të bankave të huaja 57

Subjekte jobanka 60

Subjektet financiare që nuk licencohen nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e veprimtarisë së tyre, në mbështetje të vendimit nr. 26, datë 29.03.2000, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"". 61

Zyra të këmbimeve valutore 62

Unionet e shoqërive të kursim-kreditit 69

ROLI I STATISTIKAVE NË FUNKSION TË POLITIKËS MONETARE[1]

Politika të shëndosha udhëhiqen nga mbështetje statistikore të shëndosha veçanërisht në rastin e ekonomive në tranzicion ku ndryshimet janë të vazhdueshme dhe të shpeshta. Kjo gjë vlen edhe në rastin e Shqipërisë duke qenë një vend në tranzicion, ku një nga kyçet e politikave ekonomike është mbajtja e një baze të dhënash sa më të saktë dhe të besueshme.

Ky punim paraqet një përmbledhje të informacionit statistikor në Shqipëri duke nxjerrë në plan të parë problemet kryesore të mbledhjes dhe të hartimit të tyre. Gjithashtu, përshkruhet edhe roli i statistikave në formulimin e politikave ekonomike të vendit, duke u përqendruar në politikën monetare. Punimi paraqet edhe një histori të shkurtër të politikës monetare dhe të planeve të së ardhmes për të dhënë kështu një panoramë sa më të gjerë të drejtimit të politikës monetare në Shqipëri.

1. HYRJE

Shqipëria, ashtu si dhe shumë vende të tjera në tranzicion, filloi shkëputjen e fortë nga ekonomia e përqendruar në fillim të viteve '90. Fillimi i tranzicioni të vështirë nuk la pa përfshirë edhe statistikat, duke çuar kështu në një degjenerim të proçesit të mbledhjes së të dhënave, përpunimit dhe të përhapjes së tyre. Ndonëse ekzistenca e njësisë qendrore të statistikave në Shqipëri nuk u vu asnjë herë në dyshim, në fillim të viteve '90 kjo njësi nuk ishte më në gjendje t'i siguronte asnjë informacion statistikor organeve vendimmarrëse.

Për shumë arsye, të dhënat statistikore gjatë viteve 1990-1993 ishin mjaft të dobëta për shkak të paaftësisë së autoriteteve për të monitoruar, për të matur dhe për të publikuar kategoritë makroekonomike statistikore kryesore, nivelit të ulët të mbulimit të sektorit privat të ekonomisë, për shkak të vonesave të shumta në përgatitje dhe publikime etj..

Përpjekjet e para serioze për të instaluar dhe për të vënë në përdorim një sistem të kohës të statistikave makroekonomike në Shqipëri datojnë që në fundin e vitit 1992. Falë ndihmës së Departamentit të Statistikave të FMN-së, për herë të parë u menduan dhe më pas u paraqitën të dhëna stistikore të tilla si bilanci i pagesave, statistika monetare dhe bankare, indeksi i çmimeve të konsumatorit etj.. Që nga ajo kohë e në vazhdim – pavarësisht luhatjeve të shumta që kaloi Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit – procesi i përgjithshëm i hartimit të të dhënave statistikore në përgjithësi ka shënuar progres. Në shtator të vitit 1996, të dhënat mbi paranë dhe statistikat e sistemit bankar të publikuara nga Banka e Shqipërisë do të konsideroheshin të plota , të besueshme dhe të sakta për t'u përfshirë në faqen e Shqipërisë në Statistikat Financiare Ndërkombëtare. Progresi filloi të ndjehej në vitin 1998 kur autoritetet shqiptare miratuan anëtarësimin e vendit në Sistemin e të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së. Më 22 maj 2000, Shqipëria do t'i bashkohej tetë vendeve të tjera në zhvillim kur ky system do të prezantohej zyrtarisht. Më pas Shqipëria u zgjodh nga FMN-ja si vend pilot për përgatitjen e një seti informacioni mbi praktikat statistikore kombëtare. Ky model do të përdorej jo vetëm nga Evropa, por edhe nga vende të tjera jashtë kontinentit evropian.

Tani statistikat e sipër përmendura publikohen nga tre institucione të ndryshme: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe Ministria e Financave. **Banka e Shqipërisë** (banka qendrore) është përgjegjëse për nxjerrjen dhe për publikimin e statistikave monetare dhe bankare çdo muaj, dhe statistikat e bilancit të pagesave çdo

[1] Prof. Shkëlqim Cani, Gramoz Kolasi, Referati i paraqitur në Sesionin e 54-t të ISI, "Roli i statistikave në funksion të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë " 19 gusht 2003, Berlin.

tremujor. Banka e Shqipërisë ka financuar në disa raste projekte të ndryshme statistikore, sidomos vëzhgime që synojnë ecurinë e sektorëve të veçantë të ekonomisë.

INSTAT (Instituti i statistikave – organ qeveritar), duke qenë agjencia kombëtare e statistikave, është përgjegjës jo vetëm për nxjerrjen dhe përhapjen e statistikave mbi llogaritë dhe demografinë kombëtare, por ai gëzon gjithashtu të drejtën ligjore[2] për të formuluar dhe për të zbatuar politikat e hartimit dhe të administrimit të statistikave në Shqipëri.

Ministria e Financave është përgjegjëse për publikimin dhe përhapjen e statistikave financiare qeveritare çdo tremujor.

2. STATISTIKAT MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI

Vendet në tranzicion kanë nevojë për statistika në kohë dhe të sakta për të ndërmarrë kështu politikat e duhura, në përgjigje të ndryshimeve të vrullshme të mjedisit ekonomik. Kësisoj, kërkesa për informacion statistikor është rritur, si në drejtim të llojit të informacionit ashtu edhe në drejtim të cilësisë. Gjatë viteve të fundit, mbledhja e statistikave nga autoritetet shqiptare ka patur përmirësim, falë edhe informacionit të ri që nuk ishte i mundur në të kaluarën. Sot mund të sigurohen të dhëna mbi agregatët monetarë, mbi sistemin bankar, mbi bilancin e pagesave dhe të dhëna kryesore nga sektori real. Gjithashtu, saktësia e të dhënave është përmirësuar duke favorizuar kështu besueshmërinë e këtij informacioni. Përpunimi i të dhënave statistikore bazohet në metodologjitë ndërkombëtare standarde, duke mundësuar edhe krahasimin midis vendeve. Për më tepër, veçanërisht për sa i takon të dhënave monetare dhe IÇK-së, seti i të dhënave është i përshtatshëm për zbatimin e analizave të ndryshme dhe të metodave ekonometrike që mbështesin vendimmarrjen e politikës monetare. Megjithatë, procesi i vendimmarrjes në Shqipëri nuk mund të mbështetet ende plotësisht në informacionin statistikor në dispozicion. Pavarësisht përmirësimeve të konsiderueshme në mbledhjen dhe përpunimin e këtyre të dhënave, statistikat makroekonomike përballen ende me disa probleme kryesore.

Mbulimi i të dhënave nuk është i plotë. Duke përjashtuar statistikat monetare dhe indekset e çmimit të konsumatorit (që publikohen çdo muaj), të gjitha grupet e tjera të statistikave kanë një periodicitet relativisht më të gjatë (në më të shumtën tre muaj). Gjithashtu, shtrirja kohore e të dhënave është një tjetër shqetësim. Në shumicën e rasteve, të dhënat shpërndahen me një diferencë prej tre deri në katër muaj mbas periudhës së raportimit. Shkurtimisht, dobësitë mund të përmblidheshin si më poshtë:

- Mungesë e të dhënave mbi llogaritë kombëtare.
- Të dhëna të pamjaftueshme mbi aktivitetet e sektorit privat apo joformal.
- Domosdoshmëria për të përmirësuar sondazhet dhe procedurat e llogaritjeve.
- Kuadër ligjor dhe institucional jo i përshtatshëm për statistikat.
- Shkallë e ulët e shkëmbimit të informacionit statistikor.
- Seri afatshkurtra që datojnë nga fillimi i viteve '90, me shkëputje të vazhdueshme për shkak të ndryshimeve metodologjike.

Ka rëndësi të theksojmë se tashmë janë indentifikuar dobësitë e mbledhjes së të dhënave, të përpunimit, të hartimit dhe të publikimit të tyre. Për më tepër, institucionet përgjegjëse janë të angazhuara në eliminimin e këtyre dobësive sa më shumë të jetë e mundur. Besojmë se sfidat me të cilat do të përballen autoritetet shqiptare në dy-tri vitet e ardhëshme do jenë përpjekjet domethënëse në përmirësimin e drejtimit të sektorit të statistikave. Për këtë arsye, po paraqesim si më poshtë prioritetet e punës:

Krijimi i një organi sa më të qartë të politikave. Pavarësisht ligjit ekzistues sipas të cilit, autoriteti më i lartë është Këshilli i Statistikave, në të vërtetë, *de facto*, ai luan thjesht rol këshillues. Mbetet e paqartë se cili është përgjegjësi i vendimmarrjes përsa i përket statistikave në Shqipëri. Ndonëse ky problem

[2] Këto të drejta janë të kundërshtueshme e për rrjedhojë kjo çështje është qendër e diskutimeve të shumta.

njihet prej kohësh, fatkeqësisht asnjë zgjidje nuk i është dhënë këtij vakumi ligjor. Projektligji parashikuar të miratohet në fund të vitit do të mund të zgjidhë këtë çështje.

1. Shtrirja më e gjerë e të dhënave me qëllim mbulimin e plotë të sektorit privat. Sektori privat zë thuajse 75 për qind të PBB-së në vend**,** e megjithatë shumë pak të dhëna mblidhen nga ky sektor. Një ndër arsyet kryesore për këtë është niveli i lartë i ekonomisë joformale, e për rrjedhojë autoriteteve nuk i mundësohen të dhëna mbi aktivitetin e këtij sektori. Kohët e fundit, përpjekjet e autoriteteve janë përqendruar në paraqitjen e masave të përshtatshme për zvogëlimin e ekonomisë joformale në vend.

Shtrirja më e gjerë e të dhënave duhet shoqëruar me një vërtetësi më të madhe të të dhënave. Gjithashtu, duhet forcuar besimi se informacioni i mbledhur nga organet shtetërore nuk përdoret për qëllime të tjera përveç atyre që kanë të bëjnë me zhvillimin e statistikave. Ka mjaft arsye që i detyrojnë sipërmarrjet dhe agjencitë private të regjistruara të mos japin apo të shtrembërojnë informacionin dhënë organeve shtetërore. Arsyet, për shembull, mund të jenë mospasja dijeni për sa i takon shkallës së përdormit të këtij informacioni nga organet shtetërore, mobsbesimi në to, shkalla e konfidencialitetit të informacionit, konkurrenca në treg etj..

2. Përdorimi i vëzhgimeve për nxjerrjen e informacionit të vlefshëm. Burimet kryesore të të dhënave në Shqipëri, veçanërisht mbi aktivitetet e sektorit privat dhe të tregut joformal si edhe për matjen e veprimeve ilegale, janë me të vërtetë të papërshtatshme. Si rrjedhim, për të patur statistika makroekonomike të besueshme, matjet duhen bërë duke u bazuar në të dhëna të mbledhura nga vëzhgime të hartuara mirë sipas modeleve të përshtatshme, përfaqësuese të popullsisë. Banka e Shqipërisë ka nisur të përdorë sondazhe veçanërisht në marrjen e statistikave mbi bilancin e pagesave, por sondazhet statistikore për këtë qëllim hasin probleme të modeleve dhe përfaqësimit dhe shumë procedura të matjeve duhen riparë. Kohët e fundit, banka është angazhuar gjithashtu në përdorimin e indekseve të besimit duke bërë sondazhe mbi bizneset, konsumatorët e sektorin privat, dhe rezultatet kanë qënë të kënaqshme.

3. Nxjerrja dhe publikimi sa më i shpejtë i statistikave mbi llogartë kombëtare. INSTAT është përpjekur të njehsojë llogaritë kombëtare si dhe ka premtuar se do të publikojë të gjitha të dhënat për periudhën 1995-2000. Megjithatë, shqetësimi kryesor do të jetë cilësia e shifrave që do të publikohen. Në një shkallë të konsiderueshme, cilësia e të dhënave do të vlerësohet duke u bazuar në reagimin e konsumatorit dhe në reagimin e institucioneve ndërkombëtare ndaj cilësisë së të dhënave. Kohët e fundit janë vënë në zbatim disa projekte, të cilat besoj se do të jenë mjaft të vlefshme për afrimin e statistikave të llogarive kombëtare me standartet ndërkombëtare.

4. Përmirësimi i procesit të përhapjes së informacionit statistikor nga prodhuesi tek përdoruesi. Ndonëse autoritetet janë të angazhuara në përmirësimin e cilësisë dhe të transparencës së të dhënave statistikore, kërkohen përpjekje të gjithanshme nga të gjithë ata për sa i takon hartimit të një kalendari publikimesh dhe ngushtimit të harkut kohor midis përpunimit të të dhënave përfundimtare dhe publikimit të tyre. Nga ky këndvështrim, ndoshta sfida më e madhe ka të bëjë me përdorimin e internetit dhe dizenjimin e faqeve të internetit funksionale, kështu që çdokush i interesuar për statistikat mund të shfrytëzojë informacionin e dëshiruar. Ndonëse Banka e Shqipërisë dhe INSTAT, i kanë publikuar tashmë faqet e tyre të internetit, duhet theksuar se publiku nuk ka mundësi t'i shfrytëzojë ato. Për më tepër, faqet e internetit përdoren në një nivel të tillë që nuk është edhe aq i kënaqshëm, veçanërisht sepse statistikat e paraqitura në këto faqe nuk përzgjidhen mbi një bazë profesionale. Pavarësisht nga kjo, numri në rritje i përdoruesve duhet të konsiderohet si një iniciativë e mirë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe përhapjes së të dhënave kombëtare.

5. Zbatimi i teknologjisë së informacionit që përdoret sot. Niveli i njohurive mbi përdorimin e internetit në Shqipëri është i ulët. Përveç kësaj, shumë probleme në infrastrukturën përkatëse nuk na lejojnë të përfitojmë nga përparimet e vrullshme në teknologji që ndodhin sot në botë. Pa dyshim, është e qartë se përdorimi më i gjerë i internetit për sa i takon procesit të mbledhjes së të dhënave, sjell edhe më shumë abuzime e për

pasojë, kërkohen masa më të kujdesshme për sa i takon konfidencialitetit.

6. Trajnimi i hartuesve dhe analistëve të statistikave. Proçesi i formulimit të politikave gjen mbështetje nga shumë analiza statistikore që bazohen në të dhëna të besueshme. Gjithashtu, besueshmëria e të dhënave varet deri në një farë mase nga hartuesi i tyre. Aktualisht, ka akoma vend për përmirësimin e aftësive të administratorëve aktualë të të dhënave, me qëllim përpunimin si duhet të informacionit. Për veç kësaj, pak janë trajnuar për analizimin e të dhënave nga ana statistikore, për të zhvilluar modelet që përdorin metodat ekonometrike, për të zbatuar këto metoda në rastet e paraqitura, etj.. Kështu një nga përparësitë e institucioneve që hartojnë statistikat është trajnimi i burimeve të tyre njerëzore. (duhet përmendur fakti se trajnimet janë të kushtueshme dhe ndonjëherë mund të jenë një barrë për këto institucione). Gjithashtu, këto boshllëqe në aftësitë e burimeve njerëzore mund të plotësoheshin me kualifikimin e marrë nga studentë të kualifikuar jashtë (duke supozuar se autoritetet ndërtojnë strategji të tilla për të tërhequr këtë grup punonjësish të mundshëm).

3. POLITIKA MONETARE NË SHQIPËRI.

Në rrjedhën e transformimeve ekonomike që ndodhin zakonisht në vendet në tranzicion, politika monetare në Shqipëri ka pësuar ndryshime të shumta. Do të veçonim tre periudha gjatë të cilave ndodhën dhe kthesat kryesore në këtë politikë. Hapi i parë ka të bëjë me përpjekjet e bankës qendrore për të arritur stabilitetin makroekonomik; e dyta ka të bëjë me kolapsin e ekonomisë për shkak të skemave piramidale, kur politika monetare ishte pothuajse e pafuqishme, dhe e treta ka të bëjë me përpjekjet për të rivënë dhe për të mbajtur stabilitetin në ekonomi. Në të gjitha fazat, politika monetare ka ndjekur një rrugë të përgjithshme duke pasur si objektiv përfundimtar stabilitetin e çmimeve dhe duke përdorur objektiva të ndërmjetëm për të arritur këtë. Kuadri operacional që zbatohet për kontrollin e objektivave ka ndryshuar me kalimin e kohës.

3.1. POLITIKA MONETARE GJATË VITEVE 1992 - 1996

Ashtu si edhe në shumë vende të tjera të Evropës Lindore, politika monetare në Shqipëri filloi të zbatohej në vitet e para të viteve '90. Shkëputja nga ekonomia e centralizuar u vijua me një përkeqësim të skajshëm të stabilitetit makroekonomik. Pasoja ishte një kontraktim i të gjithë ekonomisë, gjë që u reflektua me shkatërrimin e kapaciteteve prodhuese, në inflacionin e akumular si edhe në një numër të madh njerëzish të papunë. Nga ana tjetër, hemoragjia e monedhës së huaj ishte kaq e madhe duke e zbritur mjaft poshtë nivelin e rezervës zyrtare të saj. Në mesin e vitit 1992, rezerva valutore zyrtare ishte pothuaj asgjë, dhe vetëm pak javë importe.

Ky mjedis kritik përkon me kohën kur Parlamenti miratoi ligjin "Mbi Bankën e Shqipërisë" në prill 1992. Në këtë ligj, ndër të tjera ishte shprehur qartë se funksioni kryesor i Bankës së Shqipërisë është të drejtojë politikën monetare të një vendi, të sigurojë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve.



Për herë të parë, u përgatit dhe u zbatua politika monetare në mesin e vitit 1992, kur si pjesë e një programi emergjence gjashtëmujor (mbështetur nga FMN nëpërmjet marrëveshjes *Stand-By*), Banka e Shqipërisë paraqiti disa masa që synonin të vinin në kontroll ofertën e parasë. Përveç stabilitetit të çmimeve, u vendosën edhe objektiva të tjerë final për të siguruar rritje ekonomike dhe për të balancuar pozitën e jashtme të vendit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë gjatë kësaj periudhe mund të përmblidhet me anë të skemës së mëposhtme:

Që nga ajo kohë, kufizimet mbi lëvizjet e llogarisë rrjedhëse u hoqën ndërsa kapitali në transaksionet me jashtë mbeti i kufizuar.

Këto masa, të vijuara nga një politikë fiskale shumë e shtrënguar (viti i parë i qeverisë së sapozgjedhur), u konsideruan si kontribuesi kryesor në ndalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të ekuilibrit. Në fund të vitit 1992, inflacioni u ul ndjeshëm, rritja reale e PBB-së, ndonëse shifër negative, ishte katër herë më e vogël se në vitin e mëparshëm, dhe niveli i rezervës valutore të huaj u rrit shumë deri në nivelin e tre muajve importe.



Që nga ajo kohë e në vazhdim Banka e Shqipërisë adoptoi një politikë monetare që është shumë afër me regjimin monetar (monetary targeting). Kjo nënkupton se objektivi i ndërmjetëm është paraja, agregati monetar M3. Duke marrë parasysh ambientin makroekonomik të asaj kohe, kontrolli u vendos të arrihej nëpërmjet zbatimit të instrumenteve direkte të politikës monetare, si tavani i kredive dhe normat e administruara të interesit për depozitat. Ky regjim monetar nisi në kushtet kur u adoptua një regjim i kursit luhatës të këmbimit (i cili vazhdon akoma).

Proçesi i konsolidimit makroekonomik vazhdoi i shpejtë gjatë viteve 1993-1995. Gjatë kësaj periudhe efikasiteti i politikës monetare ishte i lartë duke qënë se tregu ndikohej padyshim drejtpërsëdrejti nga vënia e kufizimeve në shpërndarjen e kredisë dhe përcaktimin e nivelit dysheme për normat e interesit për depozitat në shifra relativisht të larta. Ky pozicion i politikës monetare (i lehtë për t'u përcaktuar) ishte një nga kontribuesit në uljen e inflacionit vit mbas viti deri në një vlerë një shifrore në fund të vitit 1995 (tabela 2).



3.2. POLITIKA MONETARE GJATË VITEVE 1996 – 1997

Periudha 1996-1997 i përket kohës fatale të së ashtuquajturave skema piramidale. Normat shumë të larta dhe tërheqëse të këtyre skemave i zëvendësuan më së miri normat e interesit të vendosura nga Banka e Shqipërisë, duke e kthyer politikën monetare të Bankës së Shqipërisë thjesht në një nocion. Normat e larta të interesit ishin nxitësit e derdhjes së kursimeve të publikut. Këto norma varionin nga 12-30 përqind në muaj. Disa nga kompanitë ofronin madje edhe dyfishin e principalit në dy muaj. Investorët "u infektuan" kaq shumë nga ideja për tu bërë të pasur shpejt pa punuar, sa që filluan të shisnin asetet e tyre, si shtëpitë, dhe t'i depozitonin fitimet tek skemat. Shumat e para nuk tërhiqeshin, por ato ri-investoheshin së bashku me shumat e të ardhurave nga interesi.

Aftësia e kufizuar e kompanive për të administruar si duhet depozitat e mbledhura, i detyruan këto kompani t'i ridepozitonin paratë në sistemin bankar në formën e llogarive rrjedhëse, duke e rritur jashtë mase nivelin e rezervës në sistem, që përdoret dendur për financimin e shpenzimeve buxhetore duke blerë bono thesari. Në të njëjtën kohë, u zhvilluan në vitin 1996 dhe dy fushata elektorale, e për rrjedhojë nevojat e qeverisë për likuiditet ishin të mëdha. Si pasojë, në fund të vitit 1996 inflacioni ishte tre herë më i lartë se viti i mëparshëm, ndërkohë që falimentimi i përgjithshëm i skemave piramidale kishte filluar në mënyrë të pakthyeshme. (dhjetor 1996 filloi e para).

Kolapsi përfundimtar i skemave piramidale ishte katastrofik si për ekonominë dhe për shoqërinë. Humbja e kursimeve i çoi depozituesit në protesta të dhunshme duke çuar në shkatërrimin e shumë mjeteve fikse të prekshme publike dhe private. Ekonomia ngeci në mesin e një kaosi të përgjithshëm.

Duke folur për përkeqësimin ekonomik, PBB-ja ra me 7.3 për qind ndërsa kursi i inflacionit u rrit në 42.1 për qind në dhjetor. Norma e papunësisë u rrit ndërsa monedha vendase u zhvlerësua me pothuajse 50 për qind.

Në këto kushte, Banka e Shqipërisë u detyrua të rrisë përsëri normat e interesit për depozitat, duke e çuar kështu në 32 për qind. Por, kësaj rradhe ishte më e vështirë duke qënë se besimi i publikut tek sistemi bankar ishte lëkundur. Megjithatë, kjo masë rezultoi sërish efektive në vënien e inflacionit nën kontroll. Në fund të vitit 1998, norma vjetore e inflacionit ra në 8.7 për qind. Përpjekjet si të politikës monetare dhe asaj fiskale ishin më frytdhënëse në vitet në vazhdim.



3.3. POLITIKA MONETARE GJATË VITEVE 1998 – 2003

Gjatë viteve të fundit është regjistruar një normë inflacioni e ulët, veçanërisht për një ekonomi si ajo e Shqipërisë (kjo gjë zakonisht ndodh në kushtet e një rritje të lartë ekonomike). Edhe disa fenomene shock si kriza e Kosovës në vitin 1999, shoku i naftës në vitin 2000, sollën uljen e normave të inflacionit. Duke filluar nga viti 1999 deri në korrik të vitit 2003, Banka e Shqipërisë i ka ulur në tërësi normat e interesit, por megjithatë ato mbeten ende të larta. Duhet thënë se reagimi i tregut mbetej ende i dobët kundrejt këtyre sinjaleve relaksuese të politikës monetare. Kjo reflektohet edhe në diferencën e madhe ndërmjet normave minimale të interesit për depozitat me afat dhe *yield*-it të bonove të thesarit.

Në këto kushte, Banka e Shqipërisë ka bërë një hap përpara duke ndryshuar strategjinë e saj të politikës monetare.

Ajo hoqi të gjitha instrumentet direkte të kontrollit të ofertës së parasë duke synuar kështu në një rrugë të re: atë të sigurimit të kontrollit monetar nëpërmjet tregut. Duke filluar nga tremujori i tretë i viteve 2000, Banka e Shqipërisë përdor normat e *repo*-s si instrumenti kryesor për arritjen e synimeve të saj.

4. STATISTIKAT DHE PROCESI I VENDIMMARRJES

Pavarësisht rezultateve të arritura në 10-12 vitet e fundit, duhet thënë se procesi i vendimmarrjes



nuk ka qenë aspak i lehtë. Duke marrë parasysh shkallën e konsiderueshme të mungesës së informacionit statistikor – veçanërisht të dhënat mbi llogaritë kombëtare – procesi i vendimmarrjes i Bankës së Shqipërisë është bazuar kryesisht në përdorimin e statistikave monetare.
Kjo e vertetë nuk qëndron vetëm për vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë por për të gjithë proçesin e vendimmarrjes në përgjithësi. Megjithatë, është mëse e qartë se statistikat monetare dhe bankare kanë qenë me të vërtetë ushqimi bazë i politikës monetare.

PËRDORIMI I STATISTIKAVE MONETARE DHE BANKARE

Gjatë dekadës së fundit, politika monetare ka pësuar disa ndryshime. Që nga fillimi i saj deri në ditët e sotme, regjimi i zgjedhur, ku paraja është ende objektivi i ndërmjetëm, ka mbetur i pandryshuar. Por, megjithatë, sipas marrëveshjeve të vazhdueshme me FMN-në, Banka e Shqipërisë po bën përpjekje për të arritur objektivin e saj final nëpërmjet disa kufizimeve sasiore mbi treguesit monetarë (për më shumë detaje, shih shtojcën 1).

Ky kuadër politik që është i thjeshtë deri në njëfarë mase, mundësoi që statistikat monetare dhe bankare të jenë një mbështetje statistikore e mjaftueshme për një vendimmarrje të frytshme. Publikimi i dokumenteve statistikore të tilla si sondazhet monetare dhe të dhënat monetare të autoriteteve, së bashku me të dhëna të tjera mbi tregjet financiare dhe inflacionin, konsideroheshin si të mjaftueshme kundrejt çdo ndryshimi të mundshëm të normës së interesit. [3]

Në fillim të viteve 2000, u evidentua një lloj joefikasiteti i instrumentave të mësipërm të politikës. Kësisoj, mbas heqjes së kufizimeve për kreditë në vitin 1999, një vit më vonë në vjeshtë të vitit 2000, kontrolli monetar sigurohej duke u bazuar vetëm në instrumentat e tregut. Për këtë qëllim u futën edhe ankandet javore të repove, norma e interesit të të cilave fitoi dhe atributet e përqindjes bazë në ekonomi. Që nga ajo kohë, Banka e Shqipërisë filloi të shpallte shifrën e dëshiruar të inflacionit, duke fiksuar kështu një interval nga 2-4 për qind.

Fatkeqësisht, ndryshimi në kuadrin operacional nuk shoqërohet me një rritje të konsiderueshme të informacionit statistikor. Ndoshta, ndryshimet konsistojnë më tepër në faktin se seti i statistikave të disponueshme vazhdon të rrisë numrin e vëzhgimeve, gjë që tregon edhe një përmirësim të lehtë të cilësisë së tyre.

PËRDORIMI I STATISTIKAVE TË SEKTORIT REAL

Edhe tani, vazhdon mungesa e statistikave mbi treguesit e ekonomisë reale. Tashmë ne përdorim një shportë[4] të re të IÇK-së, të përditësuar dhe të pasuruar me artikuj shtesë, por megjithatë kjo nuk ka edhe aq peshë përderisa ai mbetet zhvillimi kryesor cilësor i këtyre 3 viteve të fundit. Nga ana tjetër, ne nuk disponojmë ende set statistikash plotësisht të besueshëm mbi llogaritë kombëtare. Rritja ekonomike[5] e vendit përbëhet ende nga një shkallë besimi relativisht e ulët, ndërsa struktura e PBB-së sipas sektorëve apo e matur sipas shpenzimeve apo të ardhurave, nuk ekziston akoma. Për më tepër, frekuenca e përditësimit të rrtijes së PBB-së është e ulët, me rreth 6 muaj.

Shifrat e tregut të punës janë një tjetër tregues i joefikasitetit në fushën e statistikave në Shqipëri. Edhe pse pretendohet se norma e papunësisë matet sipas standarteve ndërkombëtare, megjithatë ideja e përgjithëshme është se ka devijime nga realiteti dhe përdorimi është i ulët. Matja e treguesve të punësimit vështirësohet edhe nga lëvizjet e shumta të migrimit nga zonat rurale, në zonat urbane apo jashtë vendit, duke e dëmtuar kështu procesin e përgjithshëm të vendimmarrjes.

PËRDORIMI I STATISTIKAVE TË SEKTORIT FISKAL

Siç u përmend edhe më parë, është përgjegjësia e Ministrisë së Financave të hartojë dhe të shpërndajë statistikat fiskale. Ndonëse tani në Shqipëri ka rreth një dekadë që funksionojnë qeveritë lokale të pavarura, megjithatë pavarësia e tyre financiare nga qeverisja qendrore është shumë e ulët. Për këtë arsye, bilanci konsolidohet dhe pjesë nga bilanci fiskal qendror publikohen nga Ministria e Financave.

[3] Gjatë viteve '90, normat e administruara të interesit për depozitat në monedhën vendase në bankat shtetërore, luanin një rol kryesor në ekonomi; ndonjëherë normat për depozitat tremujore dhe ndonjëherë normat e depozitave dymbëdhjetëmujore.
[4] Shporta e mëparshme përmbante 241 artikuj dhe sondazhet bazoheshin në konsumin e individëve, në vitin 1993.

Duhet theksuar se ndonëse ka kaluar mjaft kohë, periodiciteti i të dhënave mbetet ende një herë në tremujor, ndërkohë që publikimi bëhet tre muaj më vonë nga periudha së cilës i referohen. Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar në përgjithësi, kanë të bëjnë me llogari të qeverisë, është shumë më e lehtë për politikën monetare të indentifikojë nevojat e qeverisë për likuiditet me një shkallë saktësie (sigurisht në periudha mjaft të shkurtra kohore). Kjo bëhet veçanërisht e domosdoshme në kushtet kur Banka e Shqipërisë, siç e përcakton ligji, është e detyruar[6] të mbulojë pjesërisht deficitin buxhetor nëpërmjet kredisë direkte.

STATISTIKAT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Pa dyshim, dy kategoritë statistikore më të sakta janë ato që kanë të bëjnë me statistikat financiare dhe ato që kanë të bëjnë me bilancin e pagesave. Të dyja këto kategori publikohen që nga viti 1992 dhe në fakt ato përbëjnë bazën e informacionit për procesin e vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë.

Statistikat e bilancit të pagesave hartohen çdo tremujor, me një diferencë kohore prej 3 muajsh nga periudha së cilës i referohen. Megjithatë, disa pjesë të rëndësishme të saj, si shifrat e tregtisë së jashtme, shërbimet, remitancat etj., përgatiten çdo muaj duke qenë kështu më pranë zhvillimeve në llogarinë rrjedhëse.

Banka e Shqipërisë publikon tani paralelisht statistikat fianciare të plota në përputhje me manualin e vjetër dhe me atë të ri të statistikave të hartuara nga FMN-ja. Në fakt, burimi statistikor për vendimmarrjen në Bankën e Shqipërisë bazohet në burimin statistikor të publikuar në përputhje me manualet e mëparshme të FMN-së, me titull "Statistikat mbi paranë dhe të dhënat bankare". Më konkretisht, burimi statistikor përfshin:

- Llogaritë e autoriteteve monetare.
- Banka e Shqipërisë MHN.
- Bilanci i konsoliduar i bankave para-depozituese.
- Sondazhe monetare.
- Kriteret e ecurisë.
- Normat e interesit dhe vëllimin e transaksioneve në tregjet financiare (normat e repove, normat ndërbankare, *yield*-i i bonove të thesarit, normat e huadhënies dhe depozitim).
- Regjistrimet e kursit të këmbimit etj.
- Të dhënat hartohen çdo muaj dhe kohët e fundit departamenti i statistikave ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar metodën e përllogaritjes dhe të paraqitjes së tyre sipas udhëizimeve të reja nga FMN-ja. Statistikat financiare dhe bankare publikohen çdo muaj dhe nxjerrja e tyre njoftohet përpara. Gjithashtu, merret informacion ditor dhe javor mbi tregun ndërbankar, tregun e parasë, tregun e këmbimit valutor si edhe informacione të tjera operacionale.

Sondazhet janë një tjetër burim informacioni që Banka e Shqipërisë po përdor këto kohët e fundit për të ushqyer politikën e saj monetare. Sondazhet mbi bilancin e pagesave përballen me problemet e modeleve dhe të paraqitjes, dhe për momentin po rishikohen. Megjithatë, ka pothuaj një vit që Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë ndërtimin e indekseve të besimit dhe sondazhet e kryera rezultojnë të besueshme. Për të qenë më konkret, sondazhet kryhen çdo tremujor tek bizneset, konsumatorët dhe bankat. Rezultatet e këtyre sondazheve nuk janë publikuar ende, sepse nuk jemi plotësisht të bindur për saktësinë e tyre, dhe gjithashtu po përpiqemi të parqaqesim një seri më të gjatë të indekseve për të mundësuar kështu krahasimin. Duhet thënë se sondazhet janë të ngjashme me sondazhet e besimit të kryera nga vende të tjera, e kësisoj në të ardhmen, shifrat mund të krahasohen me ato të vendeve të tjera.

Kombinimi i gjithë këtij informacioni, d.m.th statistikat financiare[8] me të dhënat nga IÇK-ja dhe të dhënat nga situata e likuiditetit në sistemin bankar, etj, përbën burimin bazë statistikor si nga pikëpamja monetare dhe ajo

[6] Në bazë të ligjit "Mbi Bankën e Shqipërisë", Banka e Shqipërisë është e detyruar të financojë deficitin fiskal deri në një shumë të caktuar, e barabartë kjo me 5 për qind të të ardhurave mesatare fiskale, të realizuara në tre vitet e fundit.
[7] Sondazhet tek bizneset dhe konsumatorët kryhen në bashkëpunim me INSTAT, i cili ka mjetet dhe informacionin e duhur të këtyre fushave.
[8] Informacioni statistikor mujor publikohet në datën 25 të muajit pasardhës.

financiare, mbi të cilat merren dhe vendimet për fazën vijuese përsa i takon normave të interesit. Departamenti i Politikës Monetare harton çdo muaj raportin mujor të politikës monetare – një dokument ku përfshihen edhe propozimet për vendimet e ardhshme të politikës monetare - dhe ia paraqet këtë Këshillit Mbikëqyrës. Ky raport shpjegon kryesisht zhvillimet kryesore të inflacionit dhe të parasë, pritjet dhe metoda të ndryshme parashikimi mbi agregatët monetarë, mbi kursin e këmbimit dhe mbi inflacionin.

Ky dokument i nënshtrohet gjykimit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili në përfundim vendos nëse duhen bërë ndryshime, në çfarë drejtimesh dhe në çfarë mase.

PARASHIKIMI NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në tërësi, parashikimi i treguesve monetarë në Bankën e Shqipërisë identifikohet me metodën e FMN-së e njohur si programimi monetar. Sipas kësaj metode, ndryshimi në mjetet e huaja neto[9], në deficitin fiskal[10] dhe në kredinë për ekonominë[11], duke menduar të gjitha mjetet e tjera të pandryshueshme, është i barabartë me rritjen e ofertës së parasë.

Nga ana tjetër, kohët e fundit kemi filluar përdorimin e informacionit statistikor për analizat ekonometrike. Gjithashtu, duke pasur ndihmën e ekspertëve të huaj, po zbatojmë metoda ekonometrike për të ndërtuar modele, të cilat mund t'iu përshtaten strukturave tona ekonomike. Gjithashtu po bëhen përpjekje për të gjetur dhe testuar lidhjet ndërmjet tregueve makroekonomikë (duhet thënë se disa nga seritë janë mjaft të gjata për analiza të tilla).

Duke qenë se objektivi ynë kryesor është stabiliteti i çmimeve, Banka e Shqipërisë ka qenë më e shqetësuar për monitorimin dhe për kontrollin e inflacionit. Për këtë qëllim ne kemi hartuar dy ekuacione mjaft të thjeshta, që synojnë parashikimin e inflacionit. Shkurtimisht ato bazohen në:

- Një metodë empirike mbi tendencën historike të inflacionit, ku rëndësi më e madhe i jepet viteve të fundit dhe ku periudhat historike me ndikime të forta në inflacion, si për shembull viti 1997, nuk janë përfshirë.
- Një metodë më analitike, e cila vlerëson se ata faktorë kanë ndikim më domethënës në inflacion, i matur si ndryshim vjetor i indeksit të çmimit të konsumatorit *P*.

$$P_t = \alpha_1 \cdot P_{(t-1)} + \alpha_2 \cdot m_{(t-3)} + \alpha_3 \cdot e_{(t-1)} + \varepsilon_t$$

Ku *m* përfaqëson gjendjen mujore të agregatit monetar M1, rregulluar me një diferencë kohore prej 3 periudhash, dhe *e* përfaqëson kursin e këmbimit nominal efektiv i rregulluar me një diferencë kohore prej një periudhe.

Domosdoshmëria për të hartuar modele parashikimi për inflacionin u bë konkrete në fillimin e viteve 2000, kur u verifikua që në kushtet e arritjes së objektivave sasiorë të kritereve të ecurisë, gjendja e ofertës së parasë regjistroi disa herë devijime thelbësore nga vlerat e parashikuara, kur vetë inflacioni[12] nuk paraqiti devijime të tilla.

Megjithatë, modelet e sipërpërmendura të inflacionit konsiderohen se kanë shumë kufizime, veçanërisht nga pikëpamja e përdorimit të teknikave të ekonometrisë. Prandaj, po punohet paralelisht për të hartuar një model më të besueshëm, me bazë tremujore, i cili ka në fokus të tij ndarjen në të tregtueshme dhe jo-të tregtueshme të IÇK-së. Analiza të ngjashme bëhen edhe për sa i takon matjes së inflacionit të importuar dhe inflacionit bazë.

Në fund, duhet theksuar se bazuar në kërkimin e bërë nga Misioni i Asistencës Teknike të FMN-së në bashkëpunim me ekspertë të Departamentit të Kërkimeve dhe Politikës Monetare, ka kohë që po punohet për identifikimin e regjimit të ardhshëm të politikës monetare, duke u përpjekur të gjejmë një përgjigje nëse norma e repove në një moment të caktuar dhe në një masë të caktuar, ndikon plotësisht mbi inflacion apo jo?

[9] Informacion i marrë nga statistikat e bilancit të pagesave.
[10] Informacion i marrë nga statistikat e bilancit të pagesave.
[11] Kredia për ekonominë, sipas të dhënave të fundvitit 2002, është ende në shifra mjaft të ulëta, rreth 8 përqind e PBB-së, ose rreth 10 përqind e totalit të mjeteve të sistemit bankar. Kjo do të thotë që ky artikull nuk është shumë i vështirë për tu parashikuar.
[12] Objektivi final i politikës monetare bazohet në mbajtjen e inflacionit vjetor në fund të vitit brenda intervalit 2 – 4 përqind.

5. E ARDHMJA: REGJIM INFLACIONI (*INFLATION TARGETING*) APO… ?

Po t'i përgjigjeshim pyetjes së mësipërme, Banka e Shqipërisë tani ka marrë një vendim, i cili mbi të gjitha nënkupton adoptimin e regjimit të politikës monetare të quajtur *regjimi inflacionit* (IT). Banka e Shqipërisë e ka kuptuar tashmë se IT është një strategji e suksesshme, nëse nga njëra anë gjen një klimë të shëndetshme makroekonomike dhe institucionale, dhe nga ana tjetër gjen një audiencë (agjentë ekonomikë, individë, publiku i gjerë) që e kupton dhe e mirëpret.

Në këtë këndvështrim, realiteti shqiptar, pavarësisht konsolidimit makroekonomik, vlerësohet të jetë ende në hapat e parë drejt ekonomisë së tregut.

5.1. ASPEKTI MAKROEKONOMIK

INFLACIONI

Në përgjithësi, sipas literaturave të ndryshme rekomandohet që një periudhë prej dy-tre vjetësh ku inflacioni është i ulët[13] duhet të kalojë në zbatimin e regjimit *të infacionit (IT)*. Normë e ulët konsiderohet një normë inflacioni brenda 1-3 për qind. Përgjithësisht, tendenca e viteve të fundit ka qenë drejt normave të ulëta dhe për më tepër se dy vjet, inflacioni ka variuar afër nivelit të sipërm të objektivit.

Në vite të ndryshme, faktorët *shock* kanë qenë të pranishëm kur ka pasur si inflacion të lartë ashtu edhe inflacion të ulët. Mesatarisht, norma e inflacionit vjetor nga janari 1998 deri në korrik 2003 ka qenë 5.75 për qind, ndërsa gjatë tre viteve të fundit, korrik 2000 – korrik 2003, ka qenë 3.44 për qind. Nëse do të shikonim secilin nga pesë vitet e fundit, norma vjetore e inflacionit ka qenë 21.6 për qind, 0.4 për qind, 0.0 për qind, 4.2 për qind dhe 2.1 për qind respektivisht për vitet 1998, 1999, 2000 2001 dhe 2002.

Duke u bazuar në zhvillimet e deritanishme edhe pse viti i tanishëm nënkupton se inflacioni është më i lartë krahasuar me atë të dy viteve më parë, është e besueshme se tashmë pothuajse ekzistojnë kushtet paraprake për zbatimin e *regjimit të inflacionit* (IT).

KURSI I KËMBIMIT

Regjimi i kursit të këmbimit është një nga pikat e tjera të forta për adoptimin e *regjimit të inflacionit* (IT). Në rastin e Shqipërisë, është fat që Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendime që zgjedhin dhe administrojnë llojin e politikës së kursit të këmbimit në Shqipëri. Gjithashtu, që nga viti 1992 Shqipëria ka zgjedhur një regjim kursi këmbimi të luhatshëm, tipari kryesor i të cilit është përcaktimi i çmimit të monedhës nga lidhja ofertë-kërkesë. Ekzistenca e këtij regjimi është një nga kushtet për të adoptuar regjimin e inflacionit (IT), dhe kështu ky tregues përbën një pikë të fortë mbështetëse. Kjo bëhet më e



[13] Megjithatë, vende si Republika Çeke, Polonia dhe të tjera kanë adoptuar këtë regjim në kushtet kur norma e inflacionit varionte nga 6 në 10 përqind.

besueshme po të konsiderojmë qëndrueshmërinë e monedhës vendase, Lek, krahasuar me dollarin amerikan dhe me monedhën evropiane, Euro. Për të katërtin vit me rradhë, Leku ka qenë i qëndrueshëm duke e zhvendosur Bankën e Shqipërisë pak a shumë në rolin e një "spektatori të thjeshtë "për shkak të zhvillimeve në tregun e këmbimit valutor.

KONSOLIDIMI FISKAL

Pesë vitet e fundit kanë shënuar zhvillime të rëndësishme për sa i takon konsolidimit të sektorit fiskal. Deficiti buxhetor ra nga 11.3 përqind e PBB-së në vitin 1998 në 6.2 për qind e PBB-së në vitin 2002. [14] Është fakt që gjatë viteve 2000 dhe 2001, deficiti buxhetor pati "fatin" të fitonte të ardhura të konsiderueshme në monedhë të huaj (ndihmë financiare dhe të ardhurat nga privatizimi). Këto të ardhura kanë zbutur presionet fiskale mbi politikën monetare dhe si rrjedhim, sistemi bankar nuk është përballur me probleme të likuiditetit, ndërkohë që edhe Banka e Shqipërisë ka arritur kufijtë e financimit të deficitit buxhetor siç e përcakton edhe ligji.

Megjithatë, nuk mund të flasim ende për stabilitet fiskal dhe konsolidim. Për të thënë një gjë të tillë ne konsiderojmë strukturën e të ardhurave buxhetore (një pjesë e konsiderueshme e tyre vjen nga doganat) evazionin fiskal dhe, në njëfarë mënyre, format arbitrare të vjeljes së taksave dhe të vendosjes së çmimeve të referencës.

STABILITETI FINANCIAR

Nëse do të shikonim krizat e sistemeve financiare, duket sikur Shqipëria nuk ka kaluar kriza të mëdha. Kjo është e vërtetë për atë pjesë të ekonomisë që quhet "formale". Në Shqipëri , pavarësisht se ekzistojnë pesë institute sigurimi, sistemi financiar mund të identifikohet *de facto* me atë bankar. Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë se kriza e vitit 1997, ndonëse nuk u shkaktua nga sistemi bankar, megjithatë ishte një fenomen tipik financiar, pasojat e së cilës mbi treguesit makroekonomikë, prodhimin, inflacionin, papunësinë, bilancin e pagesave etj. ishin të pallogaritshme.

Pyetja që lind në këtë kontekst është: Cili është sistemi imunitar shqiptar nga krizat financiare? Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të forcuar mbikëqyrjen bankare, sistemi ynë bankar është i pazhvilluar dhe ofron një nivel të uët të ndërmjetësimit. Karakterizohet nga një përqendrim i madh dhe ai vepron në kushtet ku risku është i lartë (i gjithë spektri nga ai i politikës deri tek ai operacional), rregulloret nuk janë të plota dhe ka probleme me zbatimin e rregullave etj. Një shembull që vlen edhe si kombinim i të gjithë këtyre elementeve, është vënë re një vit më parë kur sistemi bankar u kërcënua nga tërheqja e depozitave që ndodhi gjatë periudhës mars-prill 2002.

Përveç tregut bankar, të tjera tregje dhe institucione financiare janë pothuaj joaktive. Ato sapo janë formuar dhe niveli i ekspozimit është i lartë.

Ekonomia joformale është ende prezente dhe pavarësisht nga eksperienca e hidhur, ka të dhëna se huadhënia në këtë treg vazhdon akoma, ndonëse në një masë të ulët. Sipas një sondazhi të fundit mbi bizneset të kryera nga Banka e Shqipërisë, kërkesa për kredi në tregun joformal ka rënë.

Siç mund të vihet re, mekanizmi mbrojtës i Shqipërisë drejt krizave financiare vuan nga shumë probleme, dhe ndonëse ato kanë kohë që njihen, nuk është e mundur të eliminohen. Sistemi imunitar i dobët, bën që ekonomia shqiptare të ketë një shkallë relativisht të lartë ekspozimi e për rrjedhojë, nuk plotësohet një nga kushtet e rëndësishme të r*egjimit të inflacionit* (IT).

5.2. ASPEKTI INSTITUCIONAL

Ndonëse në aspektin makroekonomik ekzistojnë faktorë që janë në favor të zgjedhjes së *regjimit të inflacionit* (IT) si regjim i politikës monetare, besohet se në aspektin institucional ka më shumë pika disavantazhi që e zbehin këtë zgjedhje.

PAVARËSIA E BANKËS QENDRORE

Ligji ofron një pozicion të pavarur të bankës qendrore, por në të vërtetë pavarësia e bankës

[14] Gjatë periudhës afatmesme, deficiti buxhetor ndaj PBB-së projektohet të jetë 5.2 për qind në vitin 2005.

qendrore është larg nga pavarësia ligjore dhe nën kërcënim. Duket sikur autoritetet e tjera nuk kanë ndër mend të respektjonë siç duhet pavarësinë e bankës qendrore. Nga ana tjetër, nuk ka garanci të mjaftueshme që pavarësia e dhënë nga ligji aktual (në tërësi apo pjesë të veçanta të tij) nuk do t'i nënshtrohet ndryshimeve të mëvonshme.

TRANSPARENCA E BANKËS QENDRORE

Gjithashtu, vlerësohet se banka qendrore nuk zbaton ende transparencën e duhur, veçanërisht përsa i takon proçesit të vendimmarrjes, në lidhje me politikën monetare.

BESUESHMËRIA E BANKËS QENDRORE

Nuk mund të themi se Banka e Shqipërisë gëzon besimin e plotë të publikut. Nga ana tjetër, adoptimi i regjimit të inflacionit (IT) e dobëson besueshmërinë e bankës qendrore nëse banka nuk i përmbahet objektivit.

PËRGJEGJSHMËRIA E BANKËS QENDRORE

Vlerësohet se përgjegjshmëria reale duhet të rritet. Banka e Shqipërisë ka marrë përsipër të respektojë të gjitha kërkesat e raportimit, por cilësia e këtij raportimi i nënshtrohet disa përmirësimeve të mëtejshme, të cilat mendohet se do të rrisin përgjegjshmërinë e Bankës së Shqipërisë.

RAPORTE JO TË MIRA ME AUTORITETET FISKALE

Bashkërendimi ndërmjet autoriteteve fiskale dhe atyre monetare nuk është në nivelet që kërkohen nga regjimi i inflacionit (IT). Në praktikë, ky mosbashkërendim e pengon Bankën e Shqipërisë të zbatojë në mënyrë efikase instrumentat për të plotësuar politikën monetare.

Në përgjithësi, aspekti institucional konsiderohet si pikë e dobët për adoptimin e regjimit të inflacionit (IT).

5.2. NIVELI I KUPTUESHMËRISË NGA PUBLIKU

Shqiptarët morën mësimet e para mbi inflacionin në fillimin e viteve '90. Me kalimin e viteve, të gjithë e kuptuan se ngritja e çmimeve rrënonte të ardhurat dhe kursimet e tyre. Megjithatë janë të paktë ata që e kuptojnë se një mision i vështirë si ai i mbajtjes së çmimeve të qëndrueshme i takon një insitucioni të quajtur Banka e Shqipërisë. Në fakt, shqiptarët mësuan një gjë: "sakrificat afatshkurtra, sjellin fitime afagjata". Të dyja forcat politike citonin këtë shprehje kur erdhën në pushtet. Pavarësisht nga kjo, ato nuk ishin në gjëndje të kuptonin mekanizmin që të çon nga një e tashme tërësisht e shkatërruar në një të ardhme më të sigurtë e më të pasur. Një provë e kësaj është periudha e pafund e tranzicionit dhe dështimet e shumta gjatë saj (këto më tepër për arsye subjektive). Një numër i kufizuar njerëzish janë në gjëndje të kuptojnë se pse nevojiten reformat serioze, ndërkohë që shumë mbeten të zhgënjyer dhe shumica i pranon me indiferencë.
Në këtë kontekst, është e vështirë të besosh se Banka e Shqipërisë do të gjejë partnerë "të përshtatshëm" që të mund të kuptojnë dhe të dallojnë si duhet vendimet e saj. Kur publiku kupton dhe mirëpret politikën e bankës qendrore, atëherë publiku dhe pritjet e tij për inflacionin (të udhëhequra nga objektivi për inflacionin) kthehen në faktorë që përcaktojnë normat e ardhshme të inflacionit.

Në fakt, njohja e publikut me politikat, bankingun, etj, përmirësimet në kuadrin institucional janë detyrat e tanishme dhe ato nuk kanë pse presin për përfunimin e kushteve të tjera paraprake. Disa nga çështjet që duhen vrojtuar, janë si më poshtë:

1. Rritja e transparencës së Bankës së Shqipërisë. Për këtë arsye, banka qendrore ka rritur numrin e publikimeve, veçanërisht ato me karakter shpjegues, prezantimet me median, kontaktet me publikun, takime e seminare, si dhe ka miratuar një strategji dhe rregullore mbi transparencën, që është në një vijë me Kodin e Praktikave të Mira të Politikës Monetare miratuar nga FMN-ja. Sipas kësaj rregulloreje, vendimet e këshillit drejtues të Bankës së Shqipërisë jo vetëm që publikohen por edhe shpjegohen sipas kontekstit në të cilin janë marrë. Raportet e politikës monetare publikohen rregullisht dhe nxjerrja e tyre i njoftohet publikut më përpara. Të dhënat statistikore të hartuara nga Banka e Shqipërisë shpjegohen të plota në shtojcat. Për momentin, publikohet në shqip metodologjia për hartimin e statistikave monetare dhe financiare (të FMN-së).

Banka e Shqipërisë ka nisur praktikën e

organizimit të konferencave vjetore, me tema të ndryshme në lidhje me Bankën e Shqipërisë si edhe mbi politikat apo statistikat ekonomike dhe monetare. (Konferenca e vitit 2000 ishte vetëm mbi statistikat). Qëllimi i tyre është afrimi dhe vënia në kontakt e akademikëve dhe ekspertëve me njëri-tjetrin dhe audiencën, vëmendjen e së cilës BSH-ja përpiqet të marrë. Përfaqësues nga këshilli drejtues i Bankës së Shqipërisë janë angazhuar në takime me studentë nga fakultetet ekonomike, duke theksuar rëndësinë e rolit të bankës qendrore në ekonomi dhe shkëmbimin e eksperiencave në formulimin e politikave.

2. Përmirësimi i marrëdhënieve me institucione të tjera shtetërore. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka adoptuar një metodë intensive drejt të gjitha organizatave ndërkombëtare (integrimi në Bashkimin Evropian, Pakti i Stabilitetit dhe diskutime të dokumenteve të tilla si strategjitë e zhvillimit për bizneset e vogla dhe të mesme). Më i njohuri është pjesëmarrja në komitetin e borxheve.

3. Rritja e përgjegjshmërisë. Banka e Shqipërisë i ka rritur kontaktet dhe raportimet e saj me dhe në Parlament, duke u munduar të zgjerohet në shpjegimet mbi proçesin e vendimmarrjes.

4. Rritja e besimit. Përveç arrijtes së objektivave dhe bërjes publike të tyre, Banka e Shqipërisë po përpiqet të fitojë publikun dhe të vendosë komunikim të rregullt me të. Banka po organizon fushata (mbi huadhënien); po mundëson bizneset të kuptojnë pritjet e ardhshme etj..

5. Arsimimi. Rëndësia e trajnimit të aftësive u përmend gjithashtu gjatë diskutimit të hapave në përmirësimin e statistikave. Kështu, procesi i arsimimit ka përfshirë edhe vetë Bankën e Shqipërisë, përveç autoriteteve të tjera dhe publikun. Banka e Shqipërisë ka ofruar edhe mbështetje financiare për këtë. Shembulli më i fundit i trajnimeve në Bankën e Shqipërisë është shkolla gjashtëmujore, Arsimimi Profesional në Statistikat e Aplikuara dhe Ekonometri, që iu ofrohet punonjësve të saj nga Universiteti i Tiranës me financim të përbashkët nga USAID.

6. Rritja e pavarësisë së bankave qendrore.

7. Përfshirja në çështje të tjera të cilat nuk janë probleme të drejtpërdrejta të Bankës së Shqipërisë, por që ndikojnë në kushtet që kërkohen për adoptimin e regjimit të inflacionit (IT). Një shembull i kësaj është përfaqësimi në grupin përgjegjës për projektin mbi përmirësimin e statistikave dhe zbatimin e plotë të kritereve të GDDS (Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave). Me qëllim lehtësimin e shpërndarjes së të dhënave statistikore përdoruesve, si edhe përmirësimin e cilësisë së këtyre të dhënave, nënshkruhen kontrata vjetore me INSTAT-in – agjencia kombëtare e statistikave. Organizohen gjithashtu seminare dhe trajnime në lidhje me të dhënat e sektorit real (përgjegjësi kjo e INSTAT-it).

Për të qenë në përputhje si edhe për të përmirësuar kushtet paraprake të përmendura më sipër, nevojitet një periudhë prej 2-3 vjetësh. Intervali i tanishëm bazohet kryesisht në pasigurinë që Banka e Shqipërisë ka rreth angazhimit të autoriteteve të tjera në adoptimin e regjimit të inflacionit (IT) dhe reagimit të publikut; në domosdoshmërinë për të ndërtuar një model makroekonomik (duke përfshirë edhe një periudhë provë); në rritjen e efikasitetit të tregut financiar në lidhje me thithjen e mjeteve joformale; në forcimin e mëtejshëm të mbikëqyrjes bankare; në aftësinë për të mbledhur informacion statistikor të ri e të besueshëm dhe për të rritur me saktësi seritë kohore egzistuese; në përmirësimin e tregut të parasë për mundësimin e një instrumenti efikas për kontrollin e parasë, etj.

6. PËRFUNDIME

Informacioni statistikor i saktë dhe kohor po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi duke qenë se politikat ekonomike janë në zhvillim për t'ju përgjigjur strukturave ekonomike më të komplikuara, të cilat dhe po i japin formë vendeve në tranzicion sot. Fatkeqësisht, në rastin e Shqipërisë ka akoma shumë për t'u bërë për sa i takon sigurimit të statistikave të sakta. Duke u fokusuar tek politika monetare, kjo mund të mbështetet në statistikat monetare dhe bankare, të hartuara nga banka. Përmirësime janë bërë në drejtim të hartimit dhe, paraqitjes së statistikave, duke i sjellë më afër standardeve

ndërkombëtare (FMN-së) dhe duke siguruar kështu një shkallë krahasimi me vendet e tjera. Hapa inkurajues po ndërmerren për sa i takon teknikave të parashikimit, të cilat përfshijnë modele testuese duke përdorur modele ekonometrike. Puna kërkimore është zgjeruar mjaft në këtë zonë. E gjithë kjo, ka mundësuar organet drejtuese të formulonin një politikë monetare të saktë gjatë këtyre viteve të fundit. Deri më tani, politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka mundur t'i shërbejë objektivit kryesor të bankës, që është stabiliteti i çmimeve. Norma e inflacionit gjatë viteve të shkuara ka qenë rreth 3 për qind.

Megjithatë, kemi parë se zhvillimi i politikës monetare, kalimi nga përdorimi i instrumenteve direkte në instrumente indirekte, synimi për të kaluar në një regjim inflacioni (IT), shtojnë presionet mbi kërkesën për statistika e për rrjedhojë, mbi domosdoshmërinë për përmirësimin e mëtejshëm të tyre. Rëndësia bëhet edhe më e madhe po të kemi parasysh edhe synimet tona afatgjata për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe për t'i çuar statistikat tona në të njëjtat nivele. Megjithëse është rrugë e gjatë dhe e vështirë, ne tashmë i kemi të qarta dhe kemi marrë angazhimet tona.

SHTOJCA I. KRITERET E ECURISË

Për aq kohë sa autoritetet shqiptare shprehin vullnetin dhe pranojnë të firmosin kontrata me FMN-në, ato janë të detyruara të zbatojnë disa kufizime sasiore,qëllimi i të cilave është të kontrollojnë mjetet e brendëshme të sistemit bankar dhe mjetet e bankës qendrore.

Në këtë kontekst, këto kufizime janë të veshura me cilësinë e objektivave monetar sasior, të ngjashëm me objektivin e ndërmjetëm për paranë në kuptimin e gjerë.

Siç u përmend edhe më lart, Shqipëria firmosi marrëveshjen e parë me FMN-në në gjysmën e dytë të vitit 1992, dhe që nga ajo kohë filloi të zbatonte kufizime sasiore për herë të parë.

Qëllimi i këtyre kufizimeve ishte vendosja e kufijve të sipërm dhe të poshtëm për tregues si: mjetet e huaja neto të Bankës së Shqipërisë (dysheme), mjetet e brendëshme neto të sistemit bankar (tavan) të ndara midis qeverisë dhe ekonomisë. Të ashtuquajturat kritere për të arritur suksesin përdoren ende sot, ndonëse disi më ndryshe nga mënyra e përdorur gjatë periudhës së tranzicionit.

Tabelë 1. Arritja objektiva në vitin 2002.

	Dhje-01	Mars-02	Qer-02	Shta-02	Dhje-02	Mars-03	Qer-03
MHN (në milionë dollarë)							
Objektivi	542.6	536.6	530.6	546.6	558.6	560.6	582.2
Aktuali	542.6	547.5	550.1	570.9	562.2	596.2	606.5
Diferenca	0.0	10.9	19.5	24.3	3.6	35.6	24.3
MBN (në miliardë lekë)							
Objektivi	78.1	83.6	89.1	90.1	95.1	97.1	98.1
Aktuali	78.1	84.8	87.6	83.5	87.1	76.5	68.9
Diferenca	0.0	1.2	-1.5	-6.6	-8.0	-20.7	-29.3
Kredia neto për qeverinë (në miliardë lekë)							
Objektivi	237.5	238.5	244.2	247.0	257.0	263.7	267.7
Aktuali	237.5	240.5	246.8	247.0	259.6	263.1	263.1
Diferenca	0.0	2.0	2.6	0.0	2.6	-0.6	-4.6

REFERENCA

1. Raportet vjetore të Bankës së Shqipërisë, 1992 – 2002.

2. Shkëlqim Cani, Banka e Shqipërisë , “Sfidat përpara për përmirësimin e e qeverisjes së statistikave në Shqipëri”, Seminar mbi qeverisjen e statistikave, Singapor maj 2002.

3. Armida San Jose - Departamenti Statistikave– “FMN, Statistikat makroekonomike në Shqipëri: Pikëpamje nga FMN-ja ”, Konferenca e parë ndërkombëtare – Informacioni statistikor në Shqipëri – Dhjetor 2001.

4. Gramoz Kolasi – Banka e Shqipërisë, “Statistikat e parasë dhe të bankave: Arritjet dhe sfidat për të ardhmen”, Konferenca e parë ndërkombëtare – Informacion statistikor mbi Shqipërinë – Dhjetor 2001.

5. Statistical Implications of Inflation Targeting, Getting the right numbers and getting the numbers right – IMF, editors Carol S. Carson, Charles Enoch, Claudia Dziobek.

FJALË PËRSHËNDETËSE NË KONFERENCËN E KATËRT TË BANKËS SË SHQIPËRISË NGA Z. SHKËLQIM CANI, GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË.

SARANDË, 11 SHTATOR 2003.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Jam shumë i lumtur që përshëndes të pranishmit e nderuar të kësaj salle, miqtë dhe bashkëpunëtorët e mi, ata që vazhdimisht kanë kontribuar në foltoret e konferencave tona të përvitshme dhe të ata që janë për herë të parë në auditorin e sivjetshëm.

Kam kënaqësi të veçantë, që në emër të organizatorëve të konferencës "Ekonomia shqiptare, arritje dhe sfida të politikës ekonomike", të shpreh falenderim dhe respekt për miqtë e mirë të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, të pranishëm sot në këtë sallë, që kanë dhënë kontribute dhe kanë lënë gjurmë në përparimin e ekonomisë tonë.

Shpresoj që takime të tilla të shërbejnë edhe si gjeste publike që flasin në gjuhën e mirënjohjes për këto kontribute që në njëfarë mënyre kanë ndihmuar Bankën e Shqipërisë të ndërmarrë organizime të mendimit shkencor për çështje që stresojnë ekonominë shqiptare.

Të nderuar kolegë dhe bashkëpunëtorë,

Shqipëria, në këta 13 vjet, ka ecur në rrugën e përparimit. Ekonomia tashmë, përfundimisht është orientuar drejt zhvillimit. Ne të gjithë, si autorë dhe përjetues të kohës sonë, jemi të prirur drejt më të mirës, drejt të ardhmes.

Të jetosh në një shoqëri, që përpiqet të ndërtojë një të ardhme më të sigurtë; të kesh institucione, që tentojnë modele të përparuara; të krijosh një mendësi popullore demokratike të orientuar nga një rezultante pozitive e llojshmërisë së ideve; është një sukses për vendin dhe për ekonominë. Në anën tjetër, shoqëria, shteti dhe mendësia shqiptare kanë evoluar, përgjithësisht, në mënyrë të njëkohshme. Kjo është ndoshta e lidhur me traditën tonë të hershme; ndoshta e imponuar nga vështirësia e mbijetesës nëpër vite; ndoshta lidhet me dëshirën e madhe për ta parë vendin dhe veten midis më të zhvilluarve.

Por, një gjë është e sigurtë, që kjo ecje e përgjithshme përpara, mbështet dhe mbështetet në një ekonomi që zhvillohet. Se sa është rritur ekonomia shqiptare dhe në ç'mënyrë; në ç'drejtime ka lëvizur dhe sa herë ka ngecur; këto nuk janë objekt i kësaj fjale. Ajo që dua të theksoj është që në fund të fundit ekonomia ka shënuar rritje të prekshme nga të gjithë. Kjo rritje bëhet mbështetje e projekteve dhe e sfidave tona të ardhme. Kjo rritje ushqen besimin se të gjithë ne po përpiqemi për t'i dhënë vetes dhe vendit çka më të mirë zhvillimi i sotëm ofron dhe se ne realisht meritojmë më shumë.

Njeriu duhet të luftojë shumë për të fituar gjithnjë e më shumë; duhet që atë që ka fituar ta përdorë mirë dhe pastaj, në fund, të ketë zemërgjerësinë dhe t'u lërë diçka të tjerëve që vijnë pas. Kështu krijohet vazhdimësia e zhvillimit.

Tashmë i kemi hedhur themelet e një zhvillimi të përgjithshëm ekonomik. Që ky zhvillim do të jetë i shpejtë apo i ngadalshëm; i sigurtë apo i brishtë; i qetë apo i ngarkuar me të papritura është edhe përtej kësaj konference. Rëndësi ka që ne i kemi projektuar ekonomisë një të ardhme ambicioze.

Realizimi i saj kërkon shumë përpjekje; kërkon mendim të qartë ekonomik; kërkon vendimmarrje të guximshme; kërkon vizion të gjerë në trajtimin e problemeve dhe strategji reale të zhvillimit ekonomik. Këtu shpresoj të shpreh më shumë kjo konferencë.

Të dashur miq,

Jemi mbledhur në këtë sallë të flasim për një argument që nuk është i panjohur për secilin prej nesh. Ajo që do të themi, mënyra se si do ta shohim të ardhmen e problemeve tona dhe

mundësitë reale të ecjes së mëtejshme përpara, jam i bindur që do të jenë të dobishme.

Ne dhe bashkëorganizatorët tanë të Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Tiranës, kemi bërë përpjekjet tona më të mira për të arritur këtë.

Edhe për këtë arsye, kam dëshirë që kjo Konferencë të vazhdojë t'i shërbejë bashkëpunimit dhe zhvillimit të përbashkët ekonomik.

Në mbyllje të fjalës time, duke shpresuar të kem përcjellë gjithë falenderimin tim për praninë tuaj në sallë, i uroj kësaj konference punë të mbarë; folësve të nderuar suksese; dhe të gjithëve së bashku një qëndrim të këndshëm në qytetin e bukur të Sarandës.

Ju falemnderit!

FJALA E GUVERNATORIT NË DREKËN E PËRSHËNDETUR NGA Z. KEMAL DERVIS.

SARANDË, 11 SHTATOR 2003.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Përpara se t'i jap fjalën z. Kemal Dervis më lejoni të them disa fjalë për këtë mik të madh të Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

Kemal Dervis ka fituar famë ndërkombëtare, veçanërisht gjatë vitit të fundit, në ndihmën e çmuar ndaj Qeverisë Turke, pikërisht në kohën kur ajo po përballej me krizën më të rëndë ekonomike në historinë e saj moderne.

Duke qenë një nga politikëbërësit më të besueshëm të tregjeve në tranzicion, z.Dervis gëzon, që nga viti 1998, postin e nderuar të një zyrtari të lartë në Bankën Botërore.

Pa dyshim, ne si shqiptarë, i jemi mjaft mirënjohës z.Dervis për kontributin e shquar personal dhe institucional, sepse siç e dimë të gjithë, Banka Botërore ka qenë një nga donatoret dhe mbështetëset më të mëdha të Shqipërisë gjatë 12 viteve tranzicioni. Për popullin turk, e jo vetëm për të, Kemal Dervis, është frymëzuesi i mesazheve që i bëjnë thirrje integrimit evropian dhe global; ai është politikani modern që ka zëvendësuar ata tradicionalë, dhe për popullin turk, ai është si vesa e mëngjesit.

Me një njohuri të shquar të situatës ekonomike dhe politike të rajonit, dhe në veçanti të rastit të Shqipërisë, Kemal Dervis gëzon simpatinë e padiskutueshme të shqiptarëve si një nga udhëheqësit kryesorë të vendit të tij, që ka mbështetur vazhdimisht dhe fuqishëm Shqipërinë, pavarësisht nga luhatjet dhe nga ndryshimet politike.

Do të më duhej një kohë e gjatë të flisja rreth Kemal Dervis dhe tipareve të tij, por jam i bindur se të gjithë jemi dëshmitarë të karrierës së tij të shkëlqyer në Bankën Botërore, të kontributit të tij personal për sigurimin e një pakete prej 16 miliardë dollarësh aq të rëndësishme, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, që do të ndihmojë rigjallërimin e ekonomisë turke, efektet e së cilës do të ndihen dhe në të gjithë rajonin, në të cilin jetojmë.

LIBERALIZIMI I LLOGARISË KAPITALE: PSE, KUR DHE SI?*

ABSTRAKT

Liberalizimi i llogarisë kapitale është një ndër proceset që duhet të ndërmarrë Shqipëria në të ardhmen e afërt. Kufizimet për lëvizjet e kapitalit nuk janë risi. Ato kanë qenë të pranishme në shumë vende të botës, veçanërisht në kohëra pështjellimesh, si luftërat apo rëniet ekonomike. Dy dekadat e fundit janë karakterizuar nga një lehtësim i vazhdueshëm i kontrolleve mbi lëvizjet e kapitalit, dhe shumë vende i kanë hapur plotësisht llogaritë e tyre kapitale.

Megjithatë, ka një numër vendesh, përfshirë Shqipërinë, në të cilat llogaria kapitale nuk është liberalizuar ende. Ndërkohë që Shqipëria nuk aplikon kufizime apo kontrolle mbi flukset hyrëse të kapitalit, ajo aplikon kontrolle mbi shumicën e flukseve dalëse të tij. Arsyet prapa nevojës së hapjes së llogarisë kapitale lidhen me përfitimet që burojnë nga ky proces, siç janë: rritja më e madhe ekonomike, diversifikimi i mundësive të investimit, zhvillimi financiar, përmbushja e kërkesave të përcaktuara nga autoritetet shqiptare në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Tregtisë dhe Bashkimin Evropian, reduktimi i ekonomisë joformale, arritja e një inflacioni të ulët dhe të qëndrueshëm etj..

Liberalizimi i llogarisë kapitale kërkon përmbushjen e disa kushteve të caktuara siç janë: një kuadër makroekonomik i shëndoshë; një infrastrukturë e fuqishme institucionale dhe rregullatore, veçanërisht në sektorin financiar; dhe një regjim i përshtatshëm i kursit të këmbimit. Rrjedhimisht, theksojmë rëndësinë e ruajtjes dhe të përmirësimit të treguesve aktualë makroekonomikë, si rritja e PBB-së dhe inflacioni, rëndësinë e monitorimit të kujdesshëm të niveleve të borxhit total, dhe veçanërisht të borxhit të jashtëm, dhe domosdoshmërinë e menjëhershme për të zhvilluar një strategji për gjenerimin e valutës, e cila do ta lejojë Shqipërinë të ruajë një gjendje të shëndetshme të bilancit të pagesave.

Përsa i përket hapave të liberalizimit, në përputhje me teorinë dhe me praktikën e deritanishme, sugjerojmë se hapja e llogarisë kapitale në Shqipëri duhet të trajtohet me kujdes. Fazimi ose sekuencimi i hapave të liberalizimit është shumë i rëndësishëm. Ai presupozon renditjen dhe kombinimin gradual të reformave strukturore e makroekonomike, për të mundësuar lëvizjen e lirë të kapitaleve.

1. Ç'ËSHTË LIBERALIZIMI I LLOGARISË KAPITALE: ARGUMENTE PRO DHE KUNDËR DHE NJË HISTORIK I SHKURTËR.

Liberalizimi i Llogarisë Kapitale *nënkupton heqjen e plotë të kontrolleve dhe kufizimeve mbi lëvizjet e kapitalit brenda dhe jashtë një vendi.* Fjala "kufizim" përdoret jo vetëm me kuptimin e ndalimit kategorik ligjor, domethënë, në rastet kur ligji ndalon plotësisht kryerjen e një transaksioni të caktuar, por edhe me kuptimin e kufizimit sasior, si dhe në rastet kur për një transaksion të dhënë, kërkohet miratimi nga një autoritet i caktuar, siç është Banka Qendrore. Në këtë pikë, është i nevojshëm të theksohet dallimi ndërmjet detyrimit për të marrë një miratim (autorizim, lejë) dhe deklaratës së kërkuar në pikën e hyrjes ose të daljes së kapitalit. Disa vende zbatojnë sistemin e deklarimit të sasisë së kapitalit që del nga vendi, thjesht për arsye statistikore ose për arsye që lidhen me taksat. Këto deklarime nuk përbëjnë kufizime apo kontrolle mbi lëvizjen e kapitalit, pasi ato nuk e pengojnë apo e ulin shpejtësinë e kësaj lëvizjeje. Është e vështirë të përcaktohet nëse një vend ka një llogari kapitali të liberalizuar apo jo, sepse kontrollet dhe kufizimet për

* Referati i mbajtur nga Z.Shkëlqim Cani, Guvernator dhe Znj.Diana Shtylla, specialiste në Bankën e Shqipërisë, në Konferencën IV të Bankës së Shqipërisë, Sarandë 11 shtator 2003.

lëvizjen e kapitalit janë të natyrës sasiore dhe cilësore. Quinn dhe Inclan (1997) matën hapjen e llogarisë kapitale në një numër vendesh duke i koduar masat që e kufizonin lëvizjen ndërkombëtare të kapitalit sipas shkallës së tyre të kufizimit.

Grafik 1: Shkalla e hapjes[1].



Është e qartë se në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar shkalla e liberalizimit të llogarisë kapitale ka ardhur duke u rritur, veçanërisht gjatë dekadës së fundit.

PAMJE E PËRGJITHSHME E KONTROLLEVE MBI LËVIZJEN E KAPITALIT.

Kapitali ka lëvizur nga një vend në një tjetër shumë kohë më parë se të ekzistonin tregjet e sofistikuara financiare dhe ato të kapitalit. Megjithatë, lëvizja e kapitalit i është nënshtruar në përmasa të ndryshme kontrolleve, madhësia dhe qëllimi i të cilave ndryshonte nga një epokë politike dhe ekonomike në një tjetër. Është gabim të mendohet që kontrollet mbi lëvizjen e kapitalit janë hequr vazhdimisht gradualisht gjatë dekadave. Ka patur periudha kur kapitali ka lëvizur nga një vend në një tjetër me më tepër lirshmëri sesa lëviz sot. E tillë ishte periudha e standardit të arit, gjatë së cilës kapitali u transferua dhe u investua në sasira të mëdha, ndërsa normat e interesit në vende të ndryshme ishin më afër njëra-tjetrës sesa kishin qenë ndonjëherë më parë. Regjimi i kursit fiks të këmbimit - standardi i arit- konsiderohej nga shumë vende si mjaft i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Kapitali afatshkurtër ndihmonte në financimin e mjaft veprimtarive të reja ekonomike në shumë vende. Periudha e arit u pasua nga periudha e luftës, e cila përfshiu dy luftërat botërore dhe periudhën ndërmjet luftërave – Rënien e madhe (1914 – 1945). Kjo periudhë u karakterizua nga një ndjenjë nacionaliste në rritje dhe nga politika që shkonin kundër bashkëpunimit ndërshtetëror. Besimi në standardin e arit u gërrye pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore dhe politikat monetare u fokusuan në zgjidhjen e problemeve të brendshme dhe kryesisht në financimin e deficiteve që lidheshin me luftën. Në vende të ndryshme në të gjithë botën u vendosën kontrolle mbi kapitalin, si mjete që mund t'i mbronin vendet nga zhvlerësimi i parasë dhe që do t'i ndihmonin ato të mbanin arin nën zotërimin e tyre. Ekonomia botërore u zhvendos brenda disa dekadave nga një etapë e zhvilluar e globalizimit dhe e ndërveprimit, në pothuajse pavarësi të plotë të shteteve nga njëri-tjetri. Lëvizja e kapitalit ishte pothuajse inekzistente, investimet ndërkombëtare shiheshin me dyshim dhe çmimet ndërkombëtare dhe normat e interesit nuk lëviznin më paralelisht. Kapitali global dhe investimi ndërkombëtar konsideroheshin, gjithashtu, si shkaqet kryesore të rënies ekonomike të viteve '30.

[1] Bazuar në Quinn and Inclan (1997).

Periudha e tretë – ajo e Bretton Woods (1945 – 1971) – ishte një përpjekje për rindërtimin e ekonomisë botërore. Transaksionet tregtare lulëzuan dhe rritja ekonomike ishte më e spikatur se kurrë. Pavarësisht nga rritja e jashtëzakonshme, shqetësimet lidhur me lëvizjen e kapitalit nuk ishin shuar. Fillimisht, Fondi Monetar Ndërkombëtar sanksionoi kontrollet për lëvizjen e kapitalit si mjet për të shmangur krizat e parasë. Këto kontrolle iu dhanë qeverive njëfarë pavarësie në zbatimin e politikës monetare aktive. Filozofia që përkrahte kontrollet mbi kapitalin, nuk u braktis deri në fund të viteve'60, kur u bë e dukshme që kapitali global nuk mund të frenohej. Tregjet e kapitalit u rigjeneruan gjatë epokës së kontrolleve, ndërkohë që regjimi i kursit fiks të këmbimit ishte tipari i përbashkët i shumë ekonomive të zhvilluara.

Në periudhën e katërt dhe përfundimtare – periudha pas Bretton Woods-it apo periudha e kurseve të luhatshme të këmbimit, tendencat ishin të ndryshme. Megjithëse disa vende hezitonin për të zëvendësuar kursin fiks të këmbimit me atë të luhatshëm, në harkun e viteve 1970 – 1990 lëvizja e kapitalit ka qenë e jashtëzakonshme. Qeveritë e vendeve të zhvilluara nuk i konsideronin kontrollet mbi kapitalin si të nevojshme, pasi kurset fikse të këmbimit nuk përbënin më një përparësi. Meqënëse kursi i luhatshëm i këmbimit mundej të akomodonte zhvillimet në tregun e kapitalit, kontrollet mund të hiqeshin pa shkaktuar probleme. Heqja e kontrolleve nxiste lëvizjen e kapitalit prej dhe në drejtim të shumë vendeve. Në vendet e dorës së dytë reformat ekonomike pakësuan kostot e transaksioneve dhe rrezikun e investimeve direkte. Si rezultat, kapitali vërshoi në ato vende, të paktën deri në fund të viteve '90, kur investitorët e huaj u ndërgjegjësuan për problemet që mund të lindnin nga regjimi i kursit fiks të këmbimit, i cili ishte ende mjaft i përhapur në vendet në zhvillim.

ARGUMENTE PRO LIBERALIZIMIT TË LLOGARISË KAPITALE.

Teoria klasike[2] sugjeron se lëvizja ndërkombëtare e kapitalit lejon vendet me kursime të kufizuara të tërheqin financime për projekte investimi në vend, lejon investitorët të diversifikojnë portofolet e tyre, shpërndan rrezikun e investimit dhe nxit tregtinë ndërkombëtare të mallrave sot për mallra në të ardhmen.

Nëse kapitali është i lirë të lëvizë nga një vend në një tjetër, atëherë individët, shoqëritë dhe vendet mund të konsumojnë aq sa dëshirojnë duke marrë hua nga jashtë kur të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme. Huamarrja nga jashtë ndihmon në zbutjen e cikleve të biznesit dhe lejon firmat vendase dhe individët të vazhdojnë konsumin dhe investimin, edhe kur prodhimi vendas dhe të ardhurat janë në nivele të ulëta.

Gjerësisht mbështetet ideja se hapja e llogarisë kapitale rrit besueshmërinë në autoritetet monetare. Sipas William McGruben dhe Darryl McLeod, të cilët krahasuan ecurinë e inflacionit në vendet që e liberalizuan llogarinë e tyre kapitale gjatë viteve '90, me ato vende që nuk e bënë këtë gjë, heqja e vazhdueshme e kontrolleve mund të çojë në uljen e normës vjetore të inflacionit deri në rreth 3 për qind. I njëjti përfundim është arritur edhe nga Eichengreen, Rose dhe Whyplosz (1996b). Ata studiuan të dhënat e variablave makroekonomikë në vendet që pësuan kriza, ndërkohë që disa prej këtyre vendeve e kishin liberalizuar llogarinë kapitale e disa të tjera jo. Autorët dolën në përfundimin se inflacioni, rritja e parasë dhe çekuilibrat tregtarë janë më të lartë në kriza që ndodhin në praninë e kontrolleve. Në një studim tjetër të bërë prej Alesina, Grilli dhe Millesi-Ferreti (1994), është bërë e qartë se vendet që vendosin kontrolle kanë tendencë të kenë inflacion më të lartë, më shumë të ardhura nga "*seignorage*", por norma reale interesi më të ulëta.

Johnson dhe të tjerë (1998) zbuluan se intensiteti i kontrolleve të kapitalit është në raport të zhdrejtë me zhvillimin ekonomik dhe në raport të drejtë me nivelin e barrierave doganore, me primin e tregut të zi dhe me luhatjen e kursit të këmbimit.

ARGUMENTE KUNDËR LIBERALIZIMIT TË LLOGARISË KAPITALE.

Një numër ekonomistësh në botë paraqesin disa argumente kundër liberalizimit të plotë ose mënyrës së zbatimit të tij në disa vende.

[2] 'Liberalizing Capital Movements" Economic Issues 17, IMF.

Disa nga këto argumente janë si vijon:

Së pari, është e vështirë të maten përfitimet neto që një vend do të vilte prej liberalizimit të llogarisë kapitale, sepse në kushte normale është e pamundur të parashikohen humbjet që një vend mund të pësojë në rast të një krize të llogarisë kapitale. Nëpërmjet një analize të përshtatshme, një vend duhet të vlerësojë, si probabilitetin e një krize, ashtu edhe humbjet potenciale që mund të shkaktohen prej saj.

Një kundërshtar i liberalizimit të llogarisë kapitale, Sebastian Edwards, ka gjetur se lëvizjet e kapitalit nuk ndihmojnë gjithmonë rritjen totale të produktivitetit. Ai i ndau vendet në grupe të veçanta sipas nivelit të tyre të zhvillimit dhe doli në përfundimin se vendet e sofistikuara financiarisht kanë për të përfituar më shumë nga liberalizimi sesa vendet e pazhvilluara financiarisht. Me fjalë të tjera, Edwards konkludoi se, një vend mund të përfitojë nga liberalizimi i llogarisë kapitale vetëm pasi të ketë arritur një nivel të caktuar të zhvillimit ekonomik. Në të njëjtën linjë mendimi, është argumentuar se vendet në zhvillim vuajnë shumë më tepër se vendet e zhvilluara në periudha krize.

Në sektorin privat, liberalizimi i llogarisë kapitale ngre çështjen e së drejtës për të marrë kredi, veçanërisht për individët dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Huamarrësit e vegjël përfitojnë më pak nga kapitali i huaj dhe goditen më ashpër nga largimet e menjëhershme të tij, për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar për të transferuar mjetet e tyre jashtë vendit dhe mundësisë së kufizuar për të përdorur shërbimet financiare.

Një numër ekonomistësh, ndonëse nuk janë plotësisht kundër liberalizimit, sugjerojnë se ky proces duhet të bëhet me kujdes dhe gradualisht. Ata argumentojnë se kthimi nga një shtet i liberalizuar në një shtet të kontrolluar, në rast krizash, mund të jetë shumë i kushtueshëm dhe i dëmshëm për ekonominë.

2. SHKALLA E LIBERALIZIMIT TË LLOGARISË KAPITALE NË SHQIPËRI DHE ARSYET PAS FLUKSEVE HYRËSE MODESTE.

Shqipëria konsiderohet si një vend me barriera të ulëta ndaj kapitalit të huaj dhe investimeve direkte. Një indeks i "*Economic Freedom*" i krijuar nga Gazeta Wall Street, e radhit Shqipërinë më lart se vende të tilla si Japonia, Kanadaja, Franca, Sllovenia, Bullgaria, Malta, Qipro dhe të gjitha vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. Kjo për arsye se, sipas rregullores sonë "Për veprimtarinë valutore"[3], kapitali hyrës nuk i nënshtrohet një procesi miratimi dhe asnjë sektor nuk është i mbyllur ndaj investimeve të huaja. Në të njëjtën mënyrë, riatdhesimi i kapitalit të huaj të investuar fillimisht si dhe fitimet që burojnë nga investimet e huaja nuk hasin pengesa në momentin e largimit nga vendi.

Sipas këtij vlerësimi 'Sipas ligjit në Shqipëri, firmat vendase dhe të huaja trajtohen në mënyrë të barabartë dhe atyre iu garantohet siguri nga shpronësimi apo shtetëzimi.' Në vetëm një rast (i rastësishëm) investitorët e huaj nuk trajtohen në mënyrë të njëjtë me rezidentët e Shqipërisë. Investitorët e huaj, të cilët investojnë në Shqipëri në bono thesari duhet të paguajnë 15 për qind tatim mbi fitimin, ndërkohë që rezidentët shqiptarë janë të detyruar të paguajnë një tatim prej 10 për qind.

Lëvizja e kapitalit brenda Shqipërisë dhe jashtë saj rregullohet nga rregullorja "Për veprimtarinë valutore", e përmirësuar më 30.07.2003. Siç u përmend edhe më lart, kapitali i huaj që hyn në vend nuk i nënshtrohet ndonjë kufizimi apo kontrolli.

Pavarësisht nga kjo, flukset hyrëse të kapitalit në Shqipëri janë shumë modeste dhe ne ndjejmë nevojën për të analizuar disa faktorë, që mund të kenë kufizuar hyrjen e kapitalit në Shqipëri.

[3] Rregullorja e "Për veprimtarisë valutore", miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës, nr. 64, datë 30.07.2003, është botuar në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, korrik 2003.

Grafik 2:Importet, eksportet, flukset financiare dhe kapitale dhe remitancat (% e PBB).



Pjesa më e madhe e kapitalit hyn në Shqipëri në formën e investimeve të huaja direkte dhe transfertave të kapitalit (kredi) për qeverinë. Në Shqipëri nuk janë bërë investime portofoli nga jashtë, ndërsa gjatë tre viteve të fundit bankat vendase kanë blerë, në shuma modeste, letra me vlerë të borxhit të qeverive të huaja.

Ndonëse jemi të ndërgjegjshëm për përfitimet që burojnë nga diversifikimi i kapitalit hyrës, ne do të dëshironim të përqëndroheshim në disa nga arsyet që mund të kenë penguar investimet e huaja direkte gjatë viteve të fundit. Ai që përfiton nga investimet direkte të huaja është vendi pritës. Sipas një pikëpamjeje të pranuar gjerësisht, investitorët e huaj direktë besohet se rrisin formimin e kapitalit vendas, rezervat teknologjike të vendit pritës dhe njohuritë administruese, si dhe përmirësojnë hyrjen në tregje të eksportit. Investimet e huaja direkte konsiderohen si një burim relativisht i qëndrueshëm i financimit nga jashtë. Nga ana tjetër, investimet e huaja direkte, për nga natyra, konsiderohen si më pak reaguese ndaj zhvillimeve të pafavorshme makroekonomike. Ato paraqiten si investime fikse, të cilat mund të likuidohen vetëm me një humbje të madhe. (Lehmann 2002). Shqipëria duket të ketë qenë më pak tërheqëse për investitorët e huaj sesa vendet e tjera të Evropës Juglindore. Kjo mund të thuhet nëse krahasojmë atë me vende të ngjashme me të si Maqedonia dhe Kroacia.

Grafik. 3: Shpërndarja e investimeve të huaja direkte ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore për vitin 2001 (100 % total).



Arsyet e ngurrimit të investitorëve për të investuar në Shqipëri mund të lidhen me:

1. **Faktorë teknologjikë**, që mund të rezultojnë në ndryshime në prodhim ndërmjet vendit investues dhe vendit pritës. Megjithëse Shqipëria mbetet prapa vendeve të tjera në zhvillim, ajo po bën përparime në drejtim të tërheqjes së teknologjisë së re. Në dy vitet e fundit, importet e makinerive dhe pajisjeve, kryesisht të lidhura me investimet në fushën e telekomunikacionit përbënin 16-18 për qind të totalit të importeve.

2. **Faktorë institucionalë**, si për shembull: rreziku i perceptuar i taksimit konfiskues, prania e ekonomisë joformale, titujt e paqartë të pronësisë dhe zbatimi i pabarabartë i ligjeve dhe i kontratave. Të gjitha këto fenomene janë vërejtur dhe janë ende të pranishme në mjedisin e biznesit shqiptar. Pavarësisht nga përmirësimet e kohëve të fundit, janë vënë re raste vendimesh arbitrare, raste evazioni dhe raste trajtimi të preferueshëm për subjekte të veçanta. Titujt e paqartë të pronësisë, të cilët shpesh rezultojnë në pronësi të dyfishtë të mjeteve, korrupsioni, vonesat, boshllëqet dhe parregullsitë në zbatimin e ligjit e bëjnë të vështirë për investitorët e huaj blerjen apo ndërtimin e ndërtesave, futjen e teknologjisë dhe angazhimin normal në veprimtari biznesi në Shqipëri. Përveç përmirësimit të kushteve të përgjithshme të biznesit në Shqipëri, ne besojmë se liberalizimi i procesit të shitblerjes së tokës do të ndihmojë investitorët e huaj gjatë aktivitetit të tyre në Shqipëri.

3. **Mangësitë e sistemit financiar dhe kufizimet e tregut të kredisë,** të cilat kanë kufizuar zhvillimin e sektorit privat. Shqipëria është një ndër vendet e Evropës Juglindore me nivel më të ulët të kredisë së brendshme ndaj sektorit privat.[4] Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për një numër arsyesh, ende po hasin vështirësi në tërheqjen e financimit nga bankat vendase.

Grafik 4: Ndërmjetësimi bankar në Shtetet e Evropës Juglindore, në vitin 2001 (në përqindje të PBB-së).



[4] Referencat nga Falcetti, Sanfey and Taci 2002.

Një sistem financiar i zhvilluar përfaqëson një ndërmjetës të mirë midis kapitalit të huaj dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vend.

4. Mungesa e informacionit dhe marketingu i pamjaftueshëm, të cilat gjithashtu kanë kufizuar hyrjen e kapitalit të huaj në vend.

5. Shqetësimet në rritje rreth pagesave, të cilat lidhen me gjendjen e bilancit të llogarisë korente. Thuhet se deficitet e llogarisë korente konsiderohen si sinjale paralajmëruese të një krize dhe deficite në rritje tentojnë të shoqërohen me kërkimin e primeve më të larta të rrezikut. (Lipschitz, Lane and Mourmouras, 2002.) Meqënëse deficiti i llogarisë korente të Shqipërisë (si përqindje e PBB-së) është rritur vazhdimisht gjatë 4 viteve të fundit, derisa ndaloi në 8.3 për qind të PBB-së në vitin 2002, rrjedhimisht mund të jenë rritur edhe shqetësimet rreth mundësisë së vendit për të shlyer borxhin e tij të jashtëm.

Pas shqyrtimit të arsyeve që fshihen prapa nivelit modest të investimeve të huaja direkte (IHD) gjatë dekadës së fundit në Shqipëri, duhet të përmendim faktin e pamohueshëm se investimet e huaja direkte, si shumica e statistikave në Shqipëri, janë subjekt i regjistrimeve jo të sakta, i vlerësimeve dhe i specifikimeve të gabuara etj.. Bilanci i pagesave shqiptar ka regjistruar vazhdimisht gabime dhe harresa të mëdha pozitive dhe kjo është një shenjë që tregon se në Shqipëri kanë hyrë flukse që nuk janë kapur. Në bazë të këtyre vëzhgimeve dhe të të dhënave të tjera, mund të konkludojmë se kapitali hyrës dhe veçanërisht flukset e investimeve të huaja direkte mund të jenë më të larta sesa janë regjistruar dhe janë paraqitur në bilancin e pagesave.

Nga ana tjetër, rrjedhjet dalëse të kapitalit ende iu nënshtrohen kufizimeve. Nuk kërkohet miratimi për transferta dalëse në *cash* nga territori i Republikës së Shqipërisë, kur shuma e transferuar për qëllime investimi në Shqipëri nga një bankë e huaj nuk është përdorur; dhe për transfertat dalëse nga territori i Republikës së Shqipërisë, për një shumë deri në totalin e kapitalit të paguar dhe për fitimet e rrjedhura nga një investim i tillë i kapitalit, në qoftë se kjo mbështetet nga dokumentacioni përkatës (ligji nr. 7764, datë 02.11.1993 "Për investimet e huaja"). Kreditë tregtare të dhëna jashtë, gjithashtu, nuk kanë nevojë për miratim, për aq kohë sa maturimi i tyre është më i shkurtër se një vit. Emigrantë që nuk janë rezidentë të Shqipërisë, gjithashtu, mund të transferojnë valutë të fituar nëpërmjet punësimit të tyre jashtë ose nga shitja apo nga investimet e pasurisë së tyre. Për të qenë në gjendje për të transferuar kapital jashtë, persona fizikë dhe juridikë, si dhe individë rezidentë të Shqipërisë, duhet të marrin miratimin e subjekteve të licencuara (bankave tregtare). Kufiri i sipërm për shumën që mund të transferohet jashtë nga një individ i vetëm u rrit nga 20,000 usd në 3.5 milionë lekë (aktualisht 28,000 usd) ose shumën ekuivalente në valutë. Megjithëse rregullorja "Për veprimtarinë valutore" nuk i lejon rezidentët të kryejnë investime direkte jashtë, investime në letra me vlerë të huaja, huadhënie ndaj jorezidentëve etj., besojmë se rezidentët shqiptarë kanë transferuar dhe vazhdojnë të transferojnë kapital jashtë vendit nëpërmjet kanaleve ligjore dhe joligjore. Në mënyrë të përmbledhur, konkludojmë se llogaria kapitale e Shqipërisë është plotësisht e liberalizuar përsa iu përket flukseve hyrëse dhe më e liberalizuar sesa sugjerohet nga legjislacioni në anën e flukseve dalëse.

3. PSE JEMI PËR LIBERALIZIMIN E LLOGARISË KAPITALE?

Jemi të mendimit se Shqipëria nuk duhet të pyesë nëse ajo duhet të liberalizojë llogarinë kapitale apo jo, por kur dhe, për më tepër, si duhet të drejtojë procesin e liberalizimit. Për arsye të ndryshme që do të paraqiten në kumtesë, duket se liberalizimi është i paevitueshëm, dhe ajo për të cilën ne duhet të kujdesemi është caktimi i hapave dhe përgatitja e një procesi të liberalizimit të tillë, që të japë përfitimet e dëshiruara dhe të pakësojë disavantazhet. Më poshtë janë paraqitur disa pika, të cilat mbështesin tezën e liberalizimit në Shqipëri.

(a) Kontrolle fiktive; ekonomi e madhe joformale; konstatimi i faktit që kontrollet mbi flukset dalëse janë

shmangur; mbështetja teorike që kontrollet për flukset dalëse janë më pak eficiente sesa kontrollet për flukset hyrëse të kapitalit.

(b) Konstatimi empirik që liberalizimi i llogarisë kapitale nxit rritjen ekonomike në vende të zhvilluara dhe veçanërisht në vende në zhvillim.

(c) Perspektiva afatgjatë për t'u integruar më shumë në sistemin financiar ndërkombëtar.

(d) Angazhimi afatshkurtër dhe afatmesëm për të plotësuar kërkesat e Bashkimit Evropian, të Organizatës Botërore të Tregtisë dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare.

a) Ka arsye të mjaftueshme për të besuar se madhësia e sektorit joformal në Evropën Juglindore, është më e madhe sesa në ekonomitë e përparuara industriale, në ekonomitë në tranzicion në Evropën Qendrore e Lindore dhe në Shtetet Baltike. Veprimtaritë joformale lulëzojnë në shtete të dobëta, ku zbatimi i ligjit është jo gjithnjë i njëjtë dhe ku barrierat e hyrjes janë të mëdha. (Falcetti, Sanfey, Taci, 2003.) Megjithëse Shqipëria nuk radhitet ndërmjet vendeve me pjesën më të madhe të sektorit joformal/PPK (vetëm 33.4 për qind kundrejt 45.1 për qind në Moldavi dhe Maqedoni), është e qartë se pjesa e sektorit joformal është nënvlerësuar si rezultat i metodës së vlerësimit të përdorur. Muent, Pissarides dhe Sanfey (2001) konkludojnë nga një vrojtim i studiove ligjore në Shqipëri se konkurrenca nga sektori joformal është pengesa më e madhe që kompanitë hasin në kryerjen e biznesit, duke lënë pas edhe aksesin ndaj financimit apo taksat. Është e qartë se në një ekonomi ku veprimtaritë e paligjshme dhe të paregjistruara luajnë një rol të rëndësishëm, rrjedhjet e paregjistruara të kapitalit si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij janë të pranishme. Veprimtaritë e paligjshme zakonisht financohen nga burime jashtë sistemit bankar, si të ardhura nga aktivitete të tjera ilegale të kryera në vend ose jashtë vendit. Shumica e transaksioneve në këtë pjesë të ekonomisë kryhen me para në dorë, e cila është lehtë të transferohet, qoftë nëpërmjet doganave, qoftë nëpërmjet kanaleve të tjera. Për të ilustruar këtë fakt, mund t'i referohemi përqindjes së ulët të importeve dhe eksporteve, që janë paguar nëpërmjet bankave. Shifrat për vitin 2002 ishin 40 dhe 44 për qind ndërsa për gjashtëmujorin e parë të vitit 2003 ato ishin 34 për qind për importet dhe 32 për qind për eksportet.

Në qoftë se nisemi nga mënyrat ligjore të transferimit të parasë jashtë, konkludojmë se një familje standarde prej 5 personash mund të transferojë jashtë vendit nëpërmjet bankave tregtare rreth 130 – 140 mijë usd në vit. Në qoftë se dikush ia del mbanë të mashtrojë sistemin ndërbankar të informacionit, gjë që nuk duhet të jetë shumë e vështirë në kushtet aktuale, atëherë ai mund të transferojë më shumë sesa shuma e caktuar, nën të njëjtin emër ose duke përdorur identitete të ndryshme. Ka arsye të mjaftueshme për ne si bankierë qendrorë të besojmë se rezidentët shqiptarë mund dhe i kapërcejnë kufizimet për lëvizjen e kapitalit. Ata tentojnë ta bëjnë këtë gjë, kur kushtet ekonomike dhe politike në vend keqësohen, kur dyshojnë se kursimet e tyre në valutë nuk janë të sigurta në bankat vendase (siç ishte rasti në mars-prill 2002) ose për arsye që lidhen me veprimtari ilegale.

Duke iu drejtuar teorisë, krahas pikave të trajtuara më lart, ne duhet të përmendim disa studime, të cilat kanë dalë në përfundimin se kontrollet në përgjithësi dhe kontrollet për rrjedhjet jashtë vendit në veçanti janë larg të qenit efektive në kufizimin e lëvizjes së kapitalit ndërmjet vendeve. Është gjetur se kontrollet kanë dështuar në një masë të konsiderueshme për të penguar flukset e investimeve të portofolit, veçanërisht kur ishte parashikuar një zhvlerësim i monedhës së vendit në të cilin ishte kryer investimi. Evidenca nga një numër vendesh dhe një numër studimesh tregon se vetëm kontrollet më gjithëpërmbledhëse dhe më të rrepta mbi flukset dalëse kanë pasur, në rastin më të mirë, efekte të kufizuara.[5]

Si përfundim, duke patur parasysh madhësinë e sektorit joformal në Shqipëri, rëndësinë e *cash*-it në ekonomi, tendencën në rritje të rezidentëve për të shmangur kontrollet dhe për të evidentuar se kontrollet mbi flukset dalëse, edhe në rastet më të mira, kanë rezultuar më pak eficiente sesa kontrollet mbi flukset hyrëse, mund të themi se kontrollet për lëvizjen e kapitalit në Shqipëri janë në një shkallë të madhe joeficiente dhe njëkohësisht të pamundura për t'u ruajtur.

[5] "Capital Account Liberalization - Theoretical and Practical Aspects", Occasional Paper 172, IMF.

b) Ekonomia shqiptare ka mjaft nevojë për financim të huaj ndërsa zhvillohet. Kapitali i huaj nevojitet si për privatizimin e subjekteve ekzistuese, ashtu edhe për ngritjen e ndërmarrjeve të reja, të cilat janë themelore për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Teoria sugjeron se një vend, i cili ka liberalizuar flukset dalëse është më tërheqës ndaj investitorëve të huaj, pasi frika e bllokimit bashkë me kapitalin e tyre në vend në rast krize është shumë më e vogël, sesa do të ishte në rastin e një llogarie kapitale jo të liberalizuar. Skema është e thjeshtë. Me pak ose aspak kontrolle mbi flukset dalëse inkurajohen flukset hyrëse, dhe më shumë flukse hyrëse ndihmojnë vendin të shpërndajë burimet me eficiencë, të sigurojë mundësi për diversifikimin e rrezikut, të zhvillojë sistemin e vet financiar, dhe të tërheqë teknologji më të mirë dhe njohuri (*know-how*) nga investitorët. Shumë studime e vrojtime kanë arritur në përfundimin se vendet në zhvillim, që kanë liberalizuar llogarinë e tyre të kapitalit kanë njohur rritje ekonomike në ritme më të larta sesa ato që kanë patur llogari kapitali të mbyllur.

Vlerësimet empirike të Quinn (1997), në analizën e tij për 58 vende, gjatë periudhës 1960 – 1989, sugjerojnë se hapja e llogarisë kapitale ka efekt të fuqishëm në rritjen e PBB-së për frymë. Sipas Bekaert, Harvey and Lundblad (2001), liberalizimi financiar çon në 1 për qind rritje në rritjen vjetore të PBB-së për frymë gjatë një periudhe pesëvjeçare dhe ky efekt është statistikisht i rëndësishëm. Bashkë me këto studime, ekzistojnë disa studime të tjera, të cilat nuk kanë gjetur lidhje reciproke ndërmjet liberalizimit dhe rritjes, ose të cilat kanë gjetur se ky korrelacion nuk vërehet për vendet në zhvillim (Arteta, Eichengreen and Wyplosz, 2001, dhe Klein and Olivei, 2000). Meqënëse ne këtu përballemi me një zgjedhje, preferojmë të konsiderojmë liberalizimin e llogarisë kapitale si përfituese për ekonominë.

c) Pas kalimit në një llogari kapitale më të hapur, do të shtohen gjithashtu shanset, që tregu financiar shqiptar të integrohet më shumë në tregun ndërkombëtar. Sa më shumë të afrohen tregjet, aq më tepër përafrohen normat e interesit dhe aq më e lehtë është të bëhen zgjedhje të duhura për investime brenda dhe jashtë vendit. Integrimi i tregut shqiptar me tregjet financiare ndërkombëtare do të jetë një proces gradual, por mbase do të duhet ca kohë derisa të bëhemi dëshmitarë të rezultateve të dëshiruara.

d) Shqipëria është angazhuar të liberalizojë llogarinë e saj kapitale dhe ka marrë përsipër ta bëjë këtë gjë brenda një kufiri kohor të caktuar. Në raportin e Grupit të Punës për Pranimin e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë[6], heqja e kontrolleve mbi kapitalin është një ndër angazhimet horizontale. Raporti thekson se: "Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën të mbajë kontrolle mbi lëvizjen e kapitalit, të cilat do të zbatohen në bazë trajtimi kombëtar. Regjimi që është aktualisht në vend do të hiqet jo më vonë se viti 2010'[7]. Njëkohësisht, Shqipëria po përgatitet të firmosë Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, e cila përbën hapin e parë drejt integrimit në Bashkimin Evropian. Kjo marrëveshje do të vendosë për Shqipërinë disa kushte lidhur me sekuencimin e liberalizimit të llogarisë kapitale dhe do të caktojë, njësoj si për angazhimet e firmosura me Organizatën Botërore të Tregtisë, një kufi kohor përtej të cilit llogaria kapitale në Shqipëri do të jetë plotësisht e liberalizuar. Ky kufi do të varet nga koha kur do të firmoset Marrëveshja e Stabilizim Asocimit. Megjithatë, në bazë të MSA-ve tashmë të firmosura me Maqedoninë dhe Kroacinë, besojmë se ky kufi nuk do të shkojë përtej vitit 2010. Siç u tregua edhe më lart, Shqipëria nuk ka vetëm dëshirën e mirë, por edhe angazhimin zyrtar për të hapur llogarinë kapitale brenda një periudhe kohore relativisht të shkurtër.

4. KUSHTET PËR LIBERALIZIMIN E LLOGARISË KAPITALE DHE SITUATA NË SHQIPËRI.

Në këtë pjesë të kumtesës do të prezantohen disa kushte përgjithësisht të pranuara, që vendet duhet të plotësojnë para se të vendosin të hapin llogarinë e tyre kapitale. Ekonomitë në tranzicion, që pranojnë lëvizjen e lirë të kapitalit nga brenda-jashtë dhe anasjelltas, janë të

[6] Shqipëria është anëtare e OBT-së që në tetor të vitit 2000.
[7] Burimi: Report of the Working Party on the Accession of Albania to the World Trade Organization; Schedule GATS – Albania, WT/ACC/ALB/51/Add.2, 13 korrik 2000.

pambrojtura. Tregjet globale të kapitalit janë shumë të mëdha, krahasuar me madhësinë e këtyre ekonomive, kështu që zhvendosjet e vogla të portofolit mund të ushtrojnë një influencë të madhe në flukset e kapitalit dhe në kushtet financiare vendase. Politikat duhet të caktohen në mënyrë të tillë që në mënyrë të ndërgjegjshme të reduktojnë rreziqet që iu kanosen këtyre vendeve (Lipschitz, Lane, Mourmouras, 2002). Me paraqitjen e çdo kushti, është përshkruar situata aktuale në Shqipëri, si edhe janë parashtruar disa propozime për të ardhmen e afërt.

a) Kuadër makroekonomik i shëndoshë dhe ristrukturim i vazhdueshëm i ekonomisë.
b) Regjim i fortë institucional dhe rregullator në sektorin financiar.
c) Aftësi për të përdorur politika fiskale, me qëllim mënjanimin e efekteve të flukseve të mëdha hyrëse ose dalëse të kapitalit.
d) Akses ndaj informacionit; transparencë e politikave dhe shpërndarje e mirë e të dhënave.
e) Përcaktimi i regjimit të duhur të kursit të këmbimit.

a) Jo të gjitha vendet e kanë hapur llogarinë kapitale kur kanë qenë në kulmin e zhvillimit të tyre ekonomik. Megjithatë, sipas pikëpamjes konvencionale, stabiliteti makroekonomik përbën një kusht paraprak kyç për liberalizimin e llogarisë kapitale. Paqëndrueshmëria ekonomike mund të thellojë dobësitë e sektorit financiar dhe liberalizimi i llogarisë kapitale në këto kushte, mund ta keqësojë gjendjen. Politikat e shëndosha makroekonomike janë thelbësore për neutralizimin e kësaj lidhjeje të ndërsjelltë. Në rastin e Shqipërisë, duhet të theksojmë edhe një herë rëndësinë e ruajtjes së stabilitetit makroekonomik; ritmet korente të rritjes së PBB-së; inflacionin në nivele të ulëta; mbajtjen e borxhit të jashtëm në nivele të përballueshme; dhe, meqënëse po flasim për liberalizimin e llogarisë kapitale, rëndësinë e përcaktimit të strategjive që nxisin aktivitetet, që gjenerojnë valutë.

Shqipëria ka një raport eksport/importi të ulët, ndërsa remitancat nga emigrantët që punojnë jashtë vendit janë pothuajse dy herë më të larta sesa eksportet. Mund të themi se eksporti real i Shqipërisë nuk është ai i mallrave, por ai i krahut të punës. Flukset hyrëse të kapitalit janë shumë më të ulëta sesa eksportet dhe remitancat të marra së bashku. Meqënëse disa nga burimet e valutës në Shqipëri (remitancat, ndihma e huaj dhe të ardhurat nga veprimtari ilegale) priten të sjellin më pak valutë në një periudhë afatmesme, ne duhet të mendojmë për burime të tjera afatgjata, nëpërmjet të cilave Shqipëria mund të financojë deficitin e llogarisë korente. Turizmi, strategjitë e nxitjes së eksporteve ose të zëvendësimit të importeve mund të ndihmojnë në reduktimin e deficitit të llogarisë korente, ndërsa strategjitë e projektuara për të tërhequr investimet e huaja direkte do të ndihmonin në rritjen e flukseve hyrëse.

b) Hapja e llogarisë kapitale e ekspozon sistemin financiar vendas ndaj konkurrencës së huaj. Për këtë arsye, shumica e vendeve në zhvillim janë përpjekur të zbatojnë reforma në sektorin financiar përpara liberalizimit të llogarisë kapitale. Këto reforma përfshijnë liberalizimin e normave të interesit për kreditë dhe depozitat, zhvillimin e instrumenteve monetare indirekte etj.. Parë nga kjo perspektivë, sektori financiar në Shqipëri ka bërë përparim në drejtim të përgatitjeve për liberalizimin. Normat e interesit për kreditë dhe depozitat u liberalizuan në vitin 2000, ndërkohë që është hequr tashmë kufiri i kredisë. Banka e Shqipërisë tashmë mbështetet në instrumentet indirekte në zbatimin e politikës së saj monetare. Nga më sipër, arrijmë në përfundimin se sistemi financiar në Shqipëri nuk është i papërshtatshëm për liberalizimin e llogarisë kapitale. Pavarësisht nga ky fakt, sistemi financiar në Shqipëri është akoma i ngushtë dhe relativisht i pazhvilluar. Sistemi bankar përbën pjesën më të madhe të sistemit financiar. Mbikëqyrja bankare ka bërë një përparim të dukshëm në drejtim të standardeve ndërkombëtare, ndërkohë që mbikëqyrja e institucioneve të tjera financiare, si për shembull e agjencive të sigurimit, kërkon reformë thelbësore.

Përveç nevojës për të përmirësuar dhe për të fuqizuar mbikëqyrjen e matur, ne duhet të vëmë theksin në domosdoshmërinë e përmirësimit të zbatimit të ligjeve, veçanërisht në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave. Çështja e pastrimit të parave është e një rëndësie të madhe në rastin e Shqipërisë, për arsye që lidhen

me sektorin e madh joformal dhe veçanërisht me aktivitetet ilegale dhe/ose kriminale që zhvillohen në këtë pjesë të ekonomisë. Lufta kundër pastrimit të parave në Shqipëri është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Rendit Publik, Bankës së Shqipërisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit. Këto institucione kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në vitin 2002, me qëllimin që të përgatitet një plan veprimi i përgjithshëm dhe të krijohet një grup përfaqësues, që do të angazhohet në "Bashkëpunimin Ndërinstitucional në Luftën kundër Pastrimit të Parave". Ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave" u miratua në vitin 2000 dhe, kohët e fundit, është amenduar nga Parlamenti Shqiptar (2003).

Banka e Shqipërisë ka kontribuar, gjithashtu, në fushatën kundër pastrimit të parave me rregulloren e miratuar në vitin 1997. Inspektorët e mbikëqyrjes nga Banka e Shqipërisë i kushtojnë vëmendje të veçantë formularëve të plotësuar për transaksionet në *cash,* për shumat mbi 2 milionë lekë ose ekuivalenten në monedhë të huaj. Autoriteti përgjegjës – Agjencia pranë Ministrisë së Financave – merr një raport të veçantë të plotësuar nga bankat tregtare dhe të kontrolluar nga inspektorët e Bankës së Shqipërisë për çdo transaksion mbi 70 milionë lekë ose ekuivalentin në monedhë të huaj. Lufta kundër pastrimit të parave bëhet akoma më e rëndësishme me çdo raport të publikuar nga organizmat ndërkombëtarë, në të cilët krimi i organizuar, kontrabanda, veprimtaritë e paligjshme etj., janë të cituar si problemet madhore të Shqipërisë.

c) Hapja ndaj tregjeve globale të kapitalit e minimizon efektin e mundshëm të veprimit të politikës monetare. Në këto kushte, leva fiskale mbetet mjeti kryesor i politikës stabilizuese. Sidoqoftë, ekzistojnë praktikisht kufizime në drejtim të aftësisë së politikës fiskale, që lidhen me balancimin e ndikimit ekspansionist të flukseve të kapitaleve hyrëse, ose me mbështetjen e veprimtarisë ekonomike, në rastet kur këto flukse kthehen prapa, pra dalin nga vendi (Lipschitz, Lane and Mourmouras, 2002). Si rrjedhojë, një vend duhet ta përshtasë politikën e tij fiskale me ndryshimet në sasitë dhe në kahun e flukseve të kapitalit. Kështu, sugjerohet që një vend të përdorë politika fiskale shtrënguese, në rast se përballet me flukse të mëdha të kapitaleve hyrëse dhe që ai të bëjë të kundërtën kur bëhet fjalë për flukse kapitalesh që dalin jashtë vendit. Nëse një vend vendos ta përdorë politikën e tij fiskale me synim stabilizimin e flukseve të kapitaleve, ai duhet të ketë një pozicion të fortë fiskal. Pozicioni fiskal i Shqipërisë është relativisht i qëndrueshëm, pavarësisht nga deficiti i lartë fiskal. Megjithatë, është fakt që përdorimi i politikës fiskale është i kufizuar nga detyrimet dhe nga programet shumëvjeçare të qeverisë, si dhe në të njëjtën kohë është subjekt i debatit dhe i miratimit nga parlamenti. Mesazhi ynë është që Shqipëria duhet të jetë shumë e kujdesshme në drejtim të administrimit të politikës së saj fiskale, në rast se vendos të liberalizojë llogarinë e vet kapitale.

d) Mundësitë për sigurimin e informacionit, politika transparente dhe shpërndarja e të

Grafik 5: Deficiti fiskal i Shqipërisë në përqindje të PBB.



dhënave marrin rëndësi në kuadrin e liberalizimit. Kur informacioni mbi një vend është i kufizuar, kontigjenti i investitorëve relativisht të painformuar është i prirur të ndjekë pas ata pak investitorë që mendohet se kanë informacion më të saktë dhe më të plotë nga të tjerët. Kjo sjellje mund të rezultojë në panik e ngutje të panevojshme të investitorëve. Aksesi i lirë ndaj informacionit i lejon investitorët të vlerësojnë rrezikun në mënyrë të pavarur dhe të shmangin mundësinë e reagimit në turma. Për këtë arsye, transparenca dhe shpërndarja e të dhënave duhet të konsiderohen si dy nga elementet thelbësore të drejtimit ekonomik. Dy nga pikat më të dobëta të Shqipërisë janë informacioni i pamjaftueshëm e i gabuar dhe shpërndarja jo e mirë e tij. Në këtë drejtim, ka mjaft për t'u bërë për përmirësimin e sistemit të informacionit, për zgjerimin e rrethit të përdoruesve të këtij informacioni, për rritjen e cilësisë dhe aksesin në të, e kështu me radhë. Përgjegjësia bie mbi të gjitha ato institucione që prodhojnë, mbledhin, përdorin dhe publikojnë informacionin, si për shembull INSTAT, ministritë, Banka e Shqipërisë etj.. Transparenca është në një nivel disi më të lartë, megjithatë edhe në këtë drejtim ka vend për përmirësime.

e) Sipas teorisë së "trilemës së pamundur", për një vend nuk mund të ketë lëvizje të lirë të kapitaleve, nëse ai ndjek një politikë monetare të pavarur dhe ruan një kurs këmbimi fiks. Ndonëse të dy tipet e regjimeve të kursit të këmbimit paraqesin mangësitë e tyre lidhur me lëvizjen e kapitaleve, faktet tregojnë se regjimi i luhatshëm i kursit të këmbimit është më pak i cënueshëm se regjimi i kursit të fiksuar. Huamarrësit e brendshëm të një vendi, që zbaton për një kohë të gjatë një regjim të kursit fiks të këmbimit mund të ndihen të sigurt, por nëpërmjet huamarrjes, ata marrin mbi vete më tepër rrezik sesa duhet. Regjimi i kursit të luhatshëm të këmbimit që aplikohet në Shqipëri dhe perspektiva e ruajtjes së këtij regjimi në të ardhmen e bëjnë më të lehtë kalimin në një llogari të hapur të kapitalit.

5. HAPAT E SUGJERUAR PËR LIBERALIZIMIN E LLOGARISË KAPITALE NË SHQIPËRI

Pavarësisht nga qëndrimi përkrahës ose jo që mbajnë ndaj liberalizimit të llogarisë kapitale, shumë ekonomistë bien dakord në një pikë të përbashkët:në rëndësinë e fazimit (ndarjes në faza) të liberalizimit të llogarisë kapitale. Fazimi nënkupton renditjen dhe kombinimin gradual të reformave strukturore e makroekonomike, për të mundësuar lëvizjen e lirë të kapitaleve. Nga njëra anë, siç e shpjeguam më lart, një vend duhet të ndërmarrë reforma në drejtim të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme dhe të lehtësimit të procesit të liberalizimit. Kontrolli mbi lëvizjen e kapitaleve nuk mund të zëvendësojë politikat e shëndosha makroekonomike, strukturore dhe financiare. Për rrjedhojë, para se të fillojmë të heqim dorë nga kontrollet, duhet të identifikojmë mangësitë e politikave të tjera, të cilat synohen të korrigjohen nga mbajtja e këtyre kontrolleve. Në zgjedhjen e ritmit, të momentit të fillimit të heqjes së kontrolleve dhe në përcaktimin e fazave të liberalizimit duhet të mbahet parasysh situata politike dhe rajonale. Po kështu, duhet të kihet parasysh edhe angazhimi i autoriteteve në procesin e liberalizimit si edhe interesi i tyre për reformat. Mund të ndodhë që, konsideratat politike të pengojnë zbatimin e një programi optimal reformash në sektorin financiar. Për rrjedhojë, është mëse e domosdoshme që autoritetet të karakterizohen nga fryma e bashkëpunimit dhe të jenë të kujdesshme dhe transparente në projektimin dhe në zbatimin e reformave.

Përmirësimi dhe forcimi i mbikëqyrjes bankare është shumë i rëndësishëm kur bëhet fjalë për liberalizimin e llogarisë kapitale. Ristrukturimi i plotë i bankave mund të kërkojë shumë kohë. Megjithatë, rekomandohet që të kalohet në liberalizim pasi të jetë ngritur kuadri i nevojshëm rregullator. Në këtë drejtim, praktikat kontabël marrin një rëndësi të veçantë. Disa prej praktikave ku duhet përqëndruar vëmendja lidhen me vlerësimin e mjeteve, me klasifikimin, me provigjonimin dhe me amortizimin e kredive etj..

Nisur nga eksperienca e vendeve të tjera, nga teoria ekonomike dhe nga "receta" mbi liberalizimin e llogarisë kapitale të përshkruar në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, të nënshkruar nga Kroacia (duke patur parasysh që marrëveshja e stabilizim asocimit, e cila do të nënshkruhet nga Shqipëria do të ketë pak a shumë të njëjtën përmbajtje), ne kemi dalë me një kuadër të përgjithshëm për liberalizimin dhe me disa sugjerime lidhur me procese të tjera, të cilat mund të ndikojnë pozitivisht në këtë drejtim.

Sqarojmë se më poshtë, me kontroll ose me liberalizim të llogarisë kapitale, do të nënkuptohet lëvizja e kapitaleve nga brenda-jashtë vendit ose kontrolli i kapitaleve që dalin jashtë, meqenëse, siç e shpjeguam më sipër, Shqipëria nuk ushtron kontroll mbi kapitalin që hyn në vend.

- Propozimi ynë, së pari, është që tatimi mbi fitimin nga bonot e thesarit që paguajnë jorezidentët, të ulet nga 15 në 10 për qind. Me këtë ndryshim, nuk do të ketë diskriminim ndaj jorezidentëve dhe praktikat jodiskriminuese janë shumë të rëndësishme në fushën e liberalizimit.

- Si rregull, një vend nis liberalizimin e lëvizjes së kapitaleve nga brenda-jashtë me heqjen e kontrollit mbi investimet direkte jashtë vendit. Ne sugjerojmë që Shqipëria të heqë gradualisht kontrollin mbi investimet direkte jashtë vendit. Në kushtet aktuale të ekonomisë dhe të biznesit në Shqipëri, jemi të mendimit që rreziku i rrjedhjes të kapitalit, me liberalizimin e investimeve direkte jashtë vendit, është i ulët. Ndërkohë që ekonomia shqiptare bëhet më konkurruese, investitorët vendas do të jenë më të gatshëm dhe më të prirur për të shfrytëzuar mundësitë e investimit në vend sesa për të eksportuar kapital jashtë. Prandaj, është mëse e arsyeshme të këmbëngulim në rëndësinë e përmirësimit të klimës së përgjithshme të investimeve në Shqipëri. Kontrolli mbi investimet jashtë mund të hiqet duke ulur gradualisht shumën tavan për transfertat jashtë vendit (për investime) dhe, më pas, duke e eliminuar përfundimisht këtë tavan. Ky proces mund të zgjasë disa vjet, por jo më shumë se 3 apo 4 vjet. Një nga mënyrat për monitorimin e investimeve direkte jashtë vendit mund të realizohet nëpërmjet Ministrisë së Financave. Kështu, Ministria e Financave mund të lëshojë fillimisht një autorizim për investime direkte jashtë vendit, për rezidentët që paraqesin dokumentacionin përkatës, i cili vërteton shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe realizimin e fitimit për një periudhë kohe të caktuar. Kjo mund të jetë një provë për kapitale "të pastra" dhe të kontrolluara. Pas njëfarë kohe, mund të hiqet kërkesa për autorizim nga Ministria e Financave dhe rezidentët mund të lejohen të investojnë lirisht, ndërkohë që për qëllime statistikore, duhet të vazhdojnë të raportojnë mbi kapitalet e eksportuara.

Ka disa procedura, të cilat mund të lehtësojnë investimet direkte nga ana e rezidentëve shqiptarë jashtë vendit. Njëra lidhet me procedurat e vizave. Është tashmë fakt, që vizat për hyrje dhe sidomos për dalje nga Shqipëria përbëjnë një pengesë për investitorët. Ka patur raste kur jorezidentë kanë hasur vështirësi në marrjen e një vize shqiptare, për të mos folur për procedurat e gjata dhe të mundimshme, në të cilat duhet të kalojnë rezidentët shqiptarë për të marrë nga një vizë hyrjeje për secilin vend të huaj, që duan të vizitojnë. Ne besojmë se, nëse lëvizja e njerëzve nga brenda - jashtë vendit e anasjelltas do të ishte më pak e ndërlikuar, investitorët e huaj ose vendas do të mund të vlerësonin më mirë mundësitë e investimeve në vend ose jashtë. Ne inkurajojmë autoritetet e huaja dhe ato në vend që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kësaj çështeje në një të ardhme sa më të afërt.

- Gjatë fazave të para të procesit të liberalizimit, duhet të nisim të shohim nga afër mundësinë e lëshimit të kredive tregtare me afat maturimi mbi një vit për jorezidentët, së bashku me huatë financiare me të njëjtin afat maturimi. Maturitetet e këtyre llojeve të kredive konsiderohen zakonisht si mbrojtje ndaj krizave. Liberalizimi i investimeve direkte jashtë vendit dhe i huave tregtare e financiare mund të shoqërohet me :

- Rishikimin e kuadrit ligjor financiar.
- Përmirësimin e statistikave dhe të procedurave standarde të Kontabilitetit.
- Forcimin e marrëveshjeve të përgjithshme për likuiditetin dhe operacionet monetare shoqëruese, si dhe të atyre lidhur me kursin e këmbimit.
- Në fazën e fundit të liberalizimit, ne

propozojmë liberalizimin e portofolit të investimeve si dhe atë të kredive e huave financiare me afat maturimi deri në një vit. Heqja e kontrolleve mbi këto transferta kapitale rekomandohet pasi të jenë përmbushur kërkesat e mëposhtme:

- Forcimi i kuadrit ligjor, i mbikëqyrjes dhe i administrimit të rrezikut.
- Reformat në sektorin dhe në korporatat financiare.
- Zhvillimi i tregjeve të kapitalit, përfshirë fondet e pensioneve.

Të gjitha rekomandimet e mësipërme bazohen në renditjen e fazave të liberalizimit, të pranuara gjerësisht nga specialistët e ekonomisë. Mund të themi se, kur bëhet fjalë për liberalizimin e llogarisë kapitale, dhe konkretisht, kur diskutohet për politikat makroekonomike, fiskale dhe monetare që zgjedhin vende të veçanta, nuk ka recetë të gatshme që të mund të japë rezultatet e dëshiruara në çdo kohë e për çdo vend. Për këtë arsye, është mëse e nevojshme të bëhet një analizë e thellë ekonomike, e cila duhet të evidentojë kushtet specifike të një vendi, lidhjen midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, ndjeshmërinë e secilit sektor ndaj zhvillimeve të jashtme etj.. Kjo analizë nuk duhet të bëhet vetëm në fillim të procesit të liberalizimit, por në secilën fazë të tij, përderisa kushtet e brendshme e të jashtme janë subjekt ndryshimesh të vazhdueshme e shpeshherë të paparashikueshme.

BIBLIOGRAFI

Alesina, Alberto, Vittorio Grilli and Gian-Maria Milesi Ferretti, 1994, “The Political Economy of Capital Controls,” *in Capital Mobility: The Impact on Consumption, Investment and Growth*, ed. By L. Leiderman and A. Razin.

Arteta, Carlos, Barry Eichengreen, and Charles Wyplosz, 2001, “On the Growth Effects of Capital Account Liberalization”.

Bekaert, Geert, Campbell Harvey, and Christian Lundblad, 2001, “Does Financial Liberalization Spur Growth?” NBER Working Paper No. 8245.

Edwards, Sebastian”Cap[ital Mobility and Economic Performance: Are Emerging Economies Different?” December, 2000.

Eichengreen, Barry, Michael Mussa, Giovanni Dell’Ariccia, Enrica Detragiache, Gian Maria Milesi-Ferretti, Andrew Tweedie, “Capital Account Liberalization- Theoretical and Practical Aspects”, IMF Occasional Paper, 1998.

Falcetti, Elisabetta, Peter Sanfey, Anita Taçi, “Bridging the gaps? Private sector development, capital flows and the investment climate in south-eastern Europe,” Working Paper No.80, EBRD, June, 2003.

H. Muent, F, Pissarides and P. Sanfey (2001), .Taxes, Competition and Finance for Albanian Enterprises: Evidence from a Field Study., *MOCT-MOST: Economic Policy in Transitional Economies*, 11(3), pp. 239-251.

Lehmann Alexander, “Foreign Direct Investment in Emerging Markets: Income, Repatriations and Financial Vulnerabilities”, IMF Working Paper/02/47.

Lipschitz Leslie, Timothy Lane and Alex Mourmouras (2002), “Capital Flows to Transition Economies: Master or Servant?”, IMF Working Paper/02/11.

Quinn, Dennis, 1997, “The Correlates of Change in International Financial Regulation,” *American Political Science Review*, Vol. 91, No. 3.

Report of the Working Party on the Accession of Albania to the World Trade Organization; Schedule GATS – Albania, WT/ACC/ALB/51/Add.2, 13 July 2000.

VLERËSIMI I EKONOMISË PËR TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2003[1]

Tre muaj para mbylljes së vitit 2003, mund të konkludohet se ekonomia ka ecur në përputhje me objektivat e programit të zhvillimit të vendit.

Ashtu si dhe në vitet e mëparshme, ekonomia shqiptare duket se do të regjistrojë një rritje tjetër të pëlqyeshme të prodhimit të përgjithshëm. Sipas treguesve më të fundit pritet që rritja reale e PBB-së të jetë në kufirin 6 për qind, aq sa ç'ishte paraparë në programin e zhvillimit ekonomik të vendit për vitin 2003. Të dhënat në dispozicion, edhe pse përsëri nuk janë të mjaftueshme, na bëjnë të besojmë se ky objektiv i rëndësishëm është i arritshëm dhe për këtë qëllim, nga moria e tyre do të veçonim:

- Prodhimi bujqësor sipas vlerësimeve të muajit korrik, gjykohet të ketë ruajtur pothuajse të pandryshuar ritmin e rritjes me atë të programuar. Evidencat tregojnë se në veçanti prodhimi agroindustrial ka manifestuar një ecuri pozitive duke regjistruar një rritje prej rreth 13 për qind në gjashtëmujorin e parë të vitit 2003, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
- Sinjalet që vijnë nga indeksi i vëllimit të shitjeve dëshmojnë për një tendencë në rritje të aktivitetit ekonomik të degëve të tjera të ekonomisë në përgjithësi. Gjallërimin më të dukshëm ekonomik në terma realë dhe nominalë, e kanë paraqitur sektorët e industrisë, të shërbimeve dhe të transport-telekomunikacionit.
- Tregues të ndryshëm të kërkesës së brendshme, si ai i konsumit të karburanteve, i importit të autoveturave dhe të pajisjeve elektroshtëpiake, kanë pësuar rritje të dukshme në krahasim me një vit më parë. Rritjen më të lartë e ka manifestuar importi i makinerive dhe pajisjeve, i cili në tremujorin e dytë të vitit 2003 u rrit me rreth 15 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
- Totali i transaksioneve të tregtisë së jashtme, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2003 është rritur ndjeshëm në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndonëse në të është përfshirë dhe ndikimi i kursit të këmbimit. Ajo që vlen të theksohet më shumë ka të bëjë me një rritje të lartë të eksporteve shqiptare gjatë tremujorit të dytë të vitit 2003, ndonëse pesha e tyre mbetet ende e ulët në vëllimin e përgjithshëm të tregtisë së jashtme.
- Situata energjitike gjatë gjithë vitit 2003, ka shënuar një përmirësim të ndjeshëm, duke zbehur skajshëm një pengesë artificiale për zhvillimin normal të aktiviteteve prodhuese dhe tregtare të vendit. Nga ana tjetër, kjo ka bërë që të ulet ndjeshëm importi i detyruar i energjisë elektrike ndonëse ne gjykojmë se duhen rritur më tej përpjekjet për minimizimin e humbjeve në rrjet.
- Ashtu si në vitet e mëparshme edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2003 është regjistruar një nivel i lartë hyrjesh valutore në formën e të ardhurave nga emigracioni, një fenomen ky që gjatë gjithë periudhës së kaluar ka qenë një burim i rëndësishëm rritjeje.

Inflacioni, objektivi tjetër final i programit të zhvillimit të vendit, duket se është në rrugën e duhur. Më konkretisht, inflacioni vjetor në fund të muajit shtator 2003, rezultoi brenda intervalit objektiv 2 – 4 për qind, të shpallur prej Bankës së Shqipërisë. Faktorët që kanë ndikuar në sjelljen e inflacionit të këtij viti janë ata tradicionalë, ndoshta me të vetmin ndryshim, që numri i shtuar i turistëve dhe rritja e

[1] Fjala e z.Shkëlqim Cani, Guvernator, në materialin "Vlerësimi i ekonomisë për tremujorin e tretë të vitit 2003"

eksporteve kanë ndikuar diçka më shumë në shtimin e presioneve mbi çmimet e mallrave ushqimorë. Ndërkohë, tregues të tjerë si ata monetarë, kursi i këmbimit, deficiti buxhetor etj., kanë ndikuar në amortizimin e presioneve të shkaktuara nga rritja e kërkesës së jashtme.

Megjithatë edhe gjatë kësaj periudhe ekonomia jonë, si një ekonomi në proces transformimi vazhdoi të prodhojë goditje nga ana e ofertës, ku më e dukshme mbetet rritja e çmimeve të administruara të energjisë elektrike si dhe rritja e akcizave dhe e taksave në muajin qershor. Bazuar në modelet parashikuese të Bankës së Shqipërisë si dhe duke shpresuar në hapat që do të ndërmarrë Banka e Shqipërisë, në drejtim të sensibilizimit të opinionit për të minimizuar spekulimet me çmimet në fund të vitit, ekziston besimi se është i mundshëm realizimi i këtij objektivi.

Të dyja politikat ekonomike bazë si ajo monetare ashtu dhe ajo fiskale, vlerësohet të kenë qenë të përshtatshme dhe brenda kornizave të programuara, duke sjellë një kontribut më shumë në drejtim të forcimit të stabilitetit makroekonomik të vendit.

Ulja e përqindjes së interesit të marrëveshjeve të riblerjes (repove) me 0.5 për qind në muajin korrik, nuk është pasuar me lëvizje të tjera të saj. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë po ndjek me vëmendje lëvizjet e përqindjeve të interesit në tregun financiar dhe në përputhje me zhvillimet në tregjet valutore, dhe me zhvillimet e pritshme në treguesit monetarë, në inflacion, në prodhim etj., është e mendimit se ekziston hapësira për një ulje të mëtejshme të përqindjes bazë të interesit 0.5 për qind, nga niveli aktual 7.5 për qind në 7 për qind.

Në përputhje me zhvillimet e fundvitit 2002 dhe të nëntë muajve të parë të vitit 2003, zhvillimet monetare janë karakterizuar nga një kthim i shpejtë i parasë në sistem. Ndërmjet specialistëve ekziston besimi se tashmë efekti i hemoragjisë së pranverës së vitit 2002 është tejkaluar, dhe se zhvillimet e fundit në zgjerimin e sistemit bankar e në përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ofruara, përbëjnë premisa për të pasur një situatë më të përshtatshme të likuiditetit në sistem.

Edhe këtë vit, ashtu si gjatë viteve të fundit ekonomia ka vazhduar të thithë financime në formën e kredisë bankare. Gjatë periudhës janar – gusht 2003 është akorduar rreth 55 miliardë lekë kredi që do të thotë 1,4 herë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Nga ana tjetër, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë flasin për një rritje të mëtejshme të aktivitetit të tregtisë së jashtme, ku ato më pozitivet i përkasin rritjes së eksporteve dhe dërgesave nga emigrantët. Edhe pse aktiviteti i turizmit duket i përmirësuar, të presim për të dhënat e tremujorit të tretë të vitit 2003, në mënyrë që të krijojmë një përfytyrim më të saktë për gjithë vitin 2003.

Kursi i këmbimit të lekut, duke pasqyruar zhvillimet me përqindjet e interesit në ekonominë amerikane dhe në atë evropiane, zhvillimet në tregjet ndërkombëtare si dhe zhvillimet e brendshme, ka manifestuar një lloj mbiçmimi ndaj dy monedhave kryesore. Në këto kushte, Banka e Shqipërisë herë pas here ka ndërhyrë në treg për të zbutur presionet e ofertës në valutë. Si rrjedhojë, rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë në vlerë absolute, në fund të muajit shtator, kanë regjistruar nivelin 965 milionë dollarë amerikanë, që korrespondon me objektivin e Bankës së Shqipërisë për të mbuluar 4.5 muaj importe.

Megjithëse ka mbetur diçka më pak se tre muaj nga mbyllja e vitit, vlerësojmë se ka ende hapësira ku mund të kërkohet dhe të vihet një kujdes më i madh, në mënyrë që ky vit jo vetëm të mbajë ritmin e programuar, por të krijojë dhe premisat për një ecuri të mbarë në të ardhmen afatshkurtër dhe në atë afatmesme. Banka e Shqipërisë vlerëson se kujdes më i madh duhet bërë në trajtimin e deficitit tregtar në rritje, i cili siç tregojnë shifrat e gjashtëmujorit, në fund të tij ka arritur në nivelin 615 milionë dollarë.

Banka e Shqipërisë vlerëson se vazhdimi i reformave të planifikuara për vitin 2003 përbën një çështje të rëndësishme në sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme për periudhat në vazhdim. Banka e Shqipërisë shpreson në një shitje të suksesshme të Bankës së Kursimeve si dhe në gjetjen e investitorit të ri të Bankës Kombëtare Tregtare. Gjykohet se të një rëndësie po kaq të madhe janë angazhimet e marra në drejtim: të një administrimi më të mirë të burimeve energjitike dhe të rrjetit shpërndarës

energjitik; të përfundimit të suksesshëm të hapave të ndërmarrë për privatizimin e Albtelekomit, të INSIG-ut etj..

Në përfundim, Banka e Shqipërisë shpreson në vazhdimin e një politike fiskale të kujdesshme për pjesën e mbetur të vitit, politikë e cila domosdoshmërisht duhet të zbusë efektet negative që ka krijuar mosrealizmi i planit të të ardhurave në masën e duhur. Përveç të tjerash, Banka e Shqipërisë gjykon se një politikë e kujdesshme do të mundësonte shmangien e presioneve mbi likuiditetin në fundin e vitit, fenomen ky që ka qenë i pranishëm historikisht duke shtuar padrejtësisht presionet mbi politikën monetare në muajin e fundit të vitit.

BULETINI I LAJMEVE, KORRIK-GUSHT-SHTATOR 2003

GUVERNATORI CANI NË TAKIMIN VJETOR TË BIS-BAZEL.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani, mori pjesë në takimin vjetor të Bankës për Rregullimet Ndërkombëtare (Bank for International Settlements), që u zhvillua nga data 28-30 qershor 2003 në Bazel të Zvicrës. Në takim përveç Guvernatorëve të bankave antare të BIS-it, merrnin pjesë edhe Guvernatorë të bankave të tjera qëndrore dhe drejtues të institucioneve financiare ndërkombëtare.

Tema kryesore e takimit të 73-të vjetor të BIS-it kishte të bënte me zhvillimet e fundit në tregjet financiare, normat e interesit të bankave qëndrore, me zhvillimet monetare dhe deflacionin në vendet e Eurozonës si dhe paraqitjen e Raportit Vjetor. Z.Nout Wellink, President i BIS-it, duke folur përpara guvernatorëve të rreth 100 bankave qendrore dhe institucioneve ndërkombëtare që ndiqnin konferencën, u shpreh se kohët e fundit po përballemi me një normë të ulët inflacioni, me rënie të kërkesës botërore dhe investimeve të komunitetit të biznesit, të pazakonshme për një situatë pas-lufte. Shqipëria ka patur 500 aksione të BIS-it që nga momenti i krijimit në vitin 1925, në vitin 1969 numri i aksioneve u dyfishua me një vlerë nominale 2 milionë e 500 mijë franga ari dhe me vlerë reale 25 për qind të shumës ose rreth 625 mijë franga ari (vlera e investuar në momentin fillestar).

Por, më 26 maj të vitit 1976, Banka e Shtetit Shqiptar kërkoi largimin nga Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare, ndërsa në muajin shtator të një viti më pas, BIS pranoi largimin e Bankës së Shtetit Shqiptar duke i kthyer shumën 3.1 milionë franga zvicerane ose 1.285 milionë dollarë. Guvernatori Cani pati një sërë takimesh me guvernatorë e personalitete të tjera të botës financiare ndërkombëtare.

BANKA E SHQIPËRISË ULI NORMËN BAZË TË INTERESIT.

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 9 korrik 2003, pasi mori në shqyrtim ecurinë dhe parashikimet e inflacionit, faktorët që priten të ndikojnë në inflacion dhe ecurinë e kushteve monetare në ekonomi, vendosi uljen e normës bazë (interesi i marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes - *repo*) me 0.5 pikë përqindjeje. Pas kësaj uljeje, norma e interesit e aplikuar për marrëveshjet e riblerjes dhe për marrëveshjet e anasjellta të riblerjes do të jetë 7.5 për qind. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në vendimin për uljen e normave të interesit, mbajti parasysh disa faktorë:

- niveli i inflacionit në fund të vitit parashikohet të jetë brenda objektivit 2-4 për qind;
- rritja e inflacionit gjatë muajve shkurt-qershor ka qenë kryesisht nën presionin e faktorëve që kanë ndikuar nga ana e ofertës;
- pritjet inflacioniste në ekonomi janë stabilizuar në nivele të pranueshme. Në përgjigje të kësaj, gjatë muajve të fundit, është vërejtur edhe një ulje e normave të interesit nga bankat e nivelit të dytë;
- kushtet monetare në ekonomi janë përmirësuar:
- norma reale e interesit, megjithëse i është afruar nivelit të saj të ekuilibrit, mbetet e lartë krahasuar me nivelet historike të saj;
- paraja jashtë bankave është në rënie të vazhdueshme dhe raporti i saj ndaj ofertës monetare është afër niveleve më të ulëta të tre viteve të fundit;
- leku ka shfaqur tendenca mbiçmuese gjatë muajve të fundit.

BANKA POPULLORE PULIEZE HAPI ZYRË PËRFAQËSIMI.

Në mbështetje të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", neni 9 pikat 4 dhe 5 si dhe të rregullores "Për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 71, datë 11.09.2002 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, me datë 15 korrik 2003, Banka e Shqipërisë me datë 15 korrik 2003 i dha të drejtën e hapjes së Zyrës së Përfaqësimit, të Bankës Popullore Pulieze në Shqipëri.

Licenca me nr.1, datë 02.07.2003, përcakton veprimtaritë e lejueshme të zyrës së përfaqësimit, e cila nuk mund të kryejë veprimtari bankare, por vetëm ka të drejtë të organizojë studime për njohjen e tregut shqiptar dhe të bëjë reklama të veprimtarisë financiare. Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.

Zyra e përfaqësimit e Bankës Popullore Pulieze ndodhet në adresën: "Sheshi "Skënderbej" - pranë Pallatit të Kulturës - kati i tretë (Tel. (04) 256 782).

GUVERNATORI TAKOHET ME MISIONIN E FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR.

Me datë 15 korrik 2003, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Shkëlqim Cani u takua me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar që vizitoi Shqipërinë, të kryesuar nga z.Jan Kees Martijn, ekonomist në Departamentin Evropian të FMN-së dhe që shoqërohej nga përfaqësuesi i Përhershëm i Zyrës së FMN-së në Shqipëri, z. Jan-Peter Olters.

Temat kryesore të diskutimit kishin të bënin me inflacionin, me zhvillimet monetare, me privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe me zhvillimet në tregun financiar. Në fjalën e tij z.Martijn u shpreh se FMN mbështet politikën monetare të Bankës së Shqipërisë dhe vendimin e fundit të Këshillit të saj Mbikëqyrës për reduktimin e normës bazë të interesit. "Me kënaqësi vërejmë se agregatët monetarë janë nën kontroll dhe se paraja jashtë bankave po kthehet me ritme të kënaqshme në sistemin bankar", u shpreh z.Martijn.

Nga ana e tij Guvernatori Cani u shpreh se Banka e Shqipërisë parashikon një normë vjetore të inflacionit brenda intervalit 2-4 për qind megjithë ndikimet e mundshme të faktorëve të ndryshëm si fluksi i turistëve, situata në prodhimin bujqësor dhe agroindustrial në vend, zgjedhjet për pushtetin vendor etj.. Lidhur me privatizimin e Bankës së Kursimeve, Guvernatori u shpreh se procesi i ristrukturimit ka shënuar zhvillime pozitive dhe Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe sidomos vetë Banka e Kursimeve tashmë kanë ngritur grupet e punës dhe po punojnë në drejtim të marketimit dhe të sqarimit të publikut lidhur me procesin e privatizimit të Bankës së Kursimeve.

GUVERNATORI NË KONFERENCËN E PËRBASHKËT PËR SHTYP ME FMN.

Në përfundim të takimeve që Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar pati me autoritetet më të larta të financave e ato monetare shqiptare gjatë periudhës 14-22 korrik 2003, lidhur me ecurinë e Marëveshjes trevjeçare me autoritetet shqiptare, me datë 23 korrik 2003 u zhvillua një konferencë shtypi e përbashkët me pjesëmarrjen e z.Hossein Samiei, Shef i Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, z.Kastriot Islami, Ministër i Financave dhe z.Shkëlqim Cani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë vlerësoi dokumentin konkludues të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar si një pasqyrë reale e analizës së ecurisë së ekonomisë shqiptare dhe e vazhdimësisë së Memorandumit të Mirëkuptimit mes Autoriteteve Shqiptare dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Banka e Shqipërisë, u shpreh Guvernatori në këtë konferencë, si gjithmonë ka qenë në kontakte dhe konsultime me Fondin Monetar Ndërkombëtar, në zbatimin e një politike monetare "të zbutur" gjatë gjithë gjysmës së parë të vitit 2003. Norma bazë e interesit u ul dy herë me nga 0.5 pikë përqindjeje. Banka e Shqipërisë me kënaqësi vuri re se bankat e nivelit të dytë dhe tregu në përgjithësi, kanë kuptuar dhe kanë reflektuar ndonjëherë edhe në avancë politikën monetare, duke ulur në mënyrë të vazhdueshme normat e interesit për kreditë dhe për depozitat. Parashikimet për treguesin e inflacionit duken pozitive dhe

megjithë ndikimet e mundshme, Banka e Shqipërisë parashikon arritjen e objektivit të saj për inflacionin edhe për vitin 2003.

GUVERNATORI U TAKUA ME STUDENTË TË FAKULTETIT EKONOMIK TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë z.Shkëlqim Cani priti në fillim të muajit korrik, 20 studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës, të përzgjedhur nga personeli akademik i Fakultetit. Takimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit institucional të Bankës së Shqipërisë me fakultetet e ekonomisë në veçanti dhe me universitetet në të gjithë vendin, dhe synonte krijimin e mundësive për punësim në Bankën e Shqipërisë për studentët më të dalluar gjatë viteve të fundit.

Ftesa e Bankës së Shqipërisë, sipas Guvernatorit, vlen për të gjithë të diplomuarit në fushën e ekonomisë, të cilët kanë arritur rezultate të larta duke mos paraqitur asnjë kufizim për pjesëmarrjen në konkurset e hapura, që zhvillon Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, institucioni qendror bankar po u krijon të gjitha kushtet e mundshme të diplomuarve të interesuar për t'u njohur me punën e Bankës së Shqipërisë, me synimin për të siguruar një personel cilësor për të ardhmen e këtij institucioni.

TAKIM ME GAZETARËT MBI PRIVATIZIMIN E BANKËS SË KURSIMEVE.

Me datë 8 gusht 2003, në ambientet e Bankës së Kursimeve u zhvillua një takim i grupit të punës së Bankës së Shqipërisë për privatizimin e Bankës së Kursimeve dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës së Kursimeve z.Adrian Kamberi, me perfaqesues te medias per te diskutuar mbi domosdoshmerine e privatizimit te Bankes se Kursimeve dhe përparësitë e një banke kursimesh private. Në takim ishin të pranishëm rreth 15 gazetarë, përfaqësues të mediave elektronike dhe të shkruara.

Takimi synonte të sqaronte pjesëmarrësit mbi domosdoshmërinë e privatizimit në sistemin bankar, mbi reformat financiare dhe përvojat e vendeve të tjera në këtë drejtim, avantazhet e krijimit të një banke kursimesh private, për të vazhduar më tej me efektet e privatizimit të Bankës së Kursimeve dhe hapat konkrete lidhur me të.

GUVERNATORI NË SESIONIN E 54-T TË INSTITUTIT NDËRKOMBËTAR TË STATISTIKAVE.

Me ftesë të Institutit Ndërkombëtar të Statistikave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Shkëlqim Cani mori pjesë në Sesionin e 54-t të Statistikave Botërore që u zhvillua në Berlin, nga data 13 deri më 20 gusht 2003, me pjesëmarrjen e më shumë se 2500 të ftuarve nga e gjithë bota nga fusha e statistikave, ekonomisë, bankingut qendror, matematikës, inxhinierisë etj.. Konferenca i zhvilloi punimet në 5 sesione dhe temat janë fokusuar kryesisht në zhvillimet dhe në perspektivat e statistikave.

Tema e prezantimit e z.Cani ishte "Roli i statistikave në funksion të politikës Monetare" dhe trajtonte si çështje kryesore ecurinë e politikës monetare; një paraqitje të statistikave makroekonomike; përdorimin e statistikave në procesin e vendimmarrjes dhe konkluzionet e rastit.

Prezantimi i z.Cani mbi zhvillimet kryesore të politikës monetare ishte i ndarë në tre çështje: skemën e përgjithshme të funksionimit të politikës monetare, periudhat kryesore dhe zhvillimet e politikës monetare në të ardhmen në aspektet makroekonomike, institucionale dhe statistikore.

ZHVILLOHET KONFERENCA E 4-T NDËRKOMBËTARE E BANKËS SË SHQIPËRISË.

Në datat 11-12 shtator 2003 në qytetin e Sarandës zhvilloi punimet konferenca "Ekonomia Shqiptare: Arritjet dhe Sfidat e Politikës Ekonomike", organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës. Ajo analizoi ecurinë e sistemit të ekonomisë së tregut, të bilancit të pagesave, të ekonomiksit të trazicionit dhe të politikës monetare.

Konferenca solli risi jo vetëm në mënyrën e organizimit të paneleve me tema të veçanta dhe të rëndësishme të zhvillimit tranzitor të ekonomive në rajon, por edhe në propozimet konkrete për autoritetet politikbërëse e vendimmarrëse, si edhe per komunitetin e biznesit.

E konceptuar si konferencë shkencore me pjesëmarrjen e personaliteteve nga jeta akademike, institucionale dhe e biznesit bankar, konferenca ballafaqoi ide mbi reduktimin e ekonomisë informale në Shqipëri, reduktimin e deficitit të bilancit të pagesave, mbi rritjen e efikasitetit të sektorit publik në këtë fazë të tranzicionit ekonomik dhe mbi rritjen e efektivitetit të politikës monetare në veçanti dhe politikave ekonomike në përgjithësi me synim stabilitetin makroekonomik dhe financiar. Por, ky stabilitet sipas referuesve, nuk duhet të prekë zhvillimin e biznesit dhe ekonomisë në përgjithësi.

Institucionet që mbështesin ndërtimin e një ekonomie të mirëfilltë tregu kanë nevojë ende të stabilizohen. Reforma institucionale në ekonomitë e trazicionit, siç është edhe ekonomia shqiptare, ka qenë më komplekse sesa pritej. Progresi jo shumë i madh i reformës institucionale duket se ka ndikuar për një zhvillim joadekuat në disa fusha të ekonomisë, siç u diskutua në konferencë.

Sipas disa referuesve, shkalla e ekonomisë informale në Shqipëri ka kapur nivele të tilla që është bërë pengesë për zhvillimin ekonomik dhe ka ndrydhur rolin e qeverisë nëpërmjet politikës së saj fiskale. Procesi i transformimit të ekonomisë informale drejt një ekonomie formale kërkon shtimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e sidomos zbatimin, e një plani edhe më të besueshëm kundër evazionit fiskal.

Nga ana tjetër qëndrueshmëria e deficitit të llogarisë korente u trajtua në Konferencë në gjetjen e mënyrës se si mund të rritet konkurueshmëria e produkteve shqiptare në funksion të zëvendësimit të importit dhe nxitjes së eksportit.

Konferenca vlerësoi procesin e integrimit por diskutoi nivelin e reformave ekonomike dhe institucionale dhe sfidat që i presin ato e në mënyrë të veçantë problemet me të drejtën e pronësisë, zhvillimin e sektorit privat si dhe të atij financiar.

Diskutimet për tregjet në zhvillim, u paraqitën si angazhim kryesor për ekonominë shqiptare dhe për ekonomitë e tjera në fazën e tranzicionit dhe theksuan domosdoshmërinë e konsolidimit të institucioneve. Kjo nuk do të thotë që politikat ekonomike e në mënyrë të veçantë politika monetare dhe zhvillimi i tregjeve financiare, nuk janë po aq të rëndësishme sa kjo fazë e tranzicionit.

Pas arritjes së stabilitetit makroekonomik në Shqipëri, është përmirësuar klima për rritjen e eficiencës dhe të rolit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, shumë vende në tranzicion kanë hasur vështirësi në arritjen e stabilitetit makroekonomik.

Konferenca u nderua me pjesëmarrjen e z.Kemal Dervis, anëtar i Parlamentit turk, i cili në përshëndetjen e rastit vlerësoi rëndësinë që kanë specifikat, jo vetëm ekonomike, por dhe sociale të ekonomive në tranzicion në hartimin dhe në zbatimin e politikave ekonomike, sidomos nga institucionet ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Nga ana e tij, z.Hossein Samiei, Shef i Divizionit Financiar në Departamentin I-rë Evropian të FMN-së, theksoi se kohët e fundit Banka e Shqipërisë ka filluar të zbatojë një politikë më sistematike monetare bazuar në ndryshimet e normave të interesit në bazë të sinjaleve që merr nga zhvillimet e inflacionit dhe të ekonomisë reale.

Drejtori Ekzekutiv i Bankës Botërore edhe për Shqipërinë, z.Franco Passacantando u fokusua në përmirësimin e klimës për aktivitetin privat në Shqipëri. Sipas tij, biznesi dhe klima e investimeve janë çelësi për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe ulje të varfërisë. Sipas z.Passacantando për klimën e biznesit janë të nevojshëm si stabiliteti makroekonomik ashtu edhe ai politik ndërsa duhen reduktuar burokracitë shtetërore që i shkaktojnë kosto aktivitetit privat dhe frenojnë investimet vendase dhe të huaja.

Gjatë punimeve të konferencës, ishin të pranishëm, referuan dhe diskutuan përfaqësues të lartë të bankave qendrore të rajonit si nga

Banka Qendrore e Turqisë, Banka Qendrore e Greqisë, Banka Kombëtare e Kroacisë dhe Banka Kombëtare e Bosnje-Hercegovinës.

Më konkretisht konferenca arriti në disa konkluzione kryesore:

Së pari, filozofia dhe politika ekonomike duhet të shikojnë nga bashkëpunimi mes qeverisë dhe tregjeve si plotësues të njëri-tjetrit, duke e bërë të qartë ndërkohë se tregjet janë thelbi i ekonomisë dhe kjo deri-diku kufizon rolin e qeverisë.

Së dyti, shteti duhet të ketë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe në mbajtjen e rritjes ekonomike. Tashmë ka ardhur koha të kuptohet drejt roli i sektorit publik, në mënyrë të veçantë në periudhat e depresionit ekonomik.

Së treti, klima për biznes në Shqipëri ka nevojë për masa shtesë që do të promovonin eksportet dhe investimet e huaja direkte, të cilat janë kthyer në domosdoshmëri për mbajtjen e ekuilibrit të jashtëm dhe për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Se katërti, autoritetet dhe komuniteti i biznesit duhet të angazhohen për respektimin e rregullave të ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës së ndershme, dhe për zbatimin e rregullave ligjorë. Biznesmenët duhet të rrisin transparencën e aktivitetit të tyre dhe duhet të drejtkuptojnë se partneriteti me autoritetet shtetërore është "çelësi" për zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat po përballet ekonomia shqiptare.

Së pesti, Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë zhvillimin e kapaciteteve në analizat e zhvillimit ekonomik në funksion të mbajtjes së stabilitetit makroekonomik dhe financiar, duke nxitur zhvillimin ekonomik.

Së gjashti, sistemi financiar, si "zemra" e ekonomisë së tregut kërkon një vëmendje të veçantë në funksion të vazhdimësisë së rritjes së mëtejshme të nivelit të kreditimit, aq i nevojshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

GUVERNATORI TAKOHET ME PERSONALITETE TË FMN-SË DHE TË BB-SË.

Në prag të takimit vjetor të Bankës Botërore (BB) dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) që u mbajt më 23-24 shtator 2003 në Dubai të Emirateve të Bashkuara Arabe, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Guvernator i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Shqipërinë, z.Shkëlqim Cani, zhvilloi një takim me zj.Carol Carson, Drejtore e Departamentit të Statistikave të FMN-së. Fillimisht, zoti Cani shprehu falenderimet në emër të institucionit që ai drejton për asistencën e vazhdueshme që Departamenti i Statistikave i ka ofruar Bankës së Shqipërisë. Nga ana e saj, zj.Carson shprehu optimizëm për bashkëpunimin e deritashëm me Bankën e Shqipërisë dhe në emër të Departamentit të Statistikave të FMN-së u angazhua në thellimin e asistencës së mëtejshme.

Në takimin me z. Michael C.Deppler, Drejtor i Departamentit I për Evropën i Fondit Monetar Ndërkombëtar, zoti Cani bëri një pasqyrë të hollësishme në lidhje me zhvillimet më të fundit në ekonominë shqiptare, duke theksuar se treguesit kryesorë të ekonomisë, përgjithësisht, po lëvizin sipas hapave të programuar.

